



USHTRIA



Viti i 77-të i botimit Nr. 11 (827866)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 15 mars 2024

Presidenti Begaj: Shqipëria, rol kontributor për paqen dhe sigurinë euroatlantike në rajon



Gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj priti presidentin e Federatës Shqiptare të Sportit Universitar, Besnik Veliu

Në ambientet e Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj priti në takim Besnik Veliu, president i Federatës Shqiptare të Sportit Universitar. Në këtë takim z. Veliu vlerësoi pjesëmarrjen dinjitoze të ekipeve të AFA-së në aktivitetin e zhvilluar në qytetin e Korçës; planet e mundshme për bashkëpunimin; nevojën për krijimin sa më shpejt të shoqatës sportive të AFA-së. Në shenjë mirënjohjeje zoti Veliu i dorëzoi gjeneral Bardhyl Nuredinajt, zëvendëskomandantit të AFA-së, një certifikatë për pjesëmarrje në aktivitetin e zhvilluar në Korçë. Gjeneral Nuredinaj e falënderoi për vlerësimin e bërë ndaj ekipeve të AFA-së, si dhe e garantoi se AFA-ja do të jetë një IAL që do marrë pjesë aktive në të gjitha aktivitetet që do të zhvillojë FSHSU në vijimësi.



AFA, pjesë e panairit "Work & Study"



Në Qendrën e Arsimit Profesional të Nënoficerëve filloi kursi i Lartë i Nënoficerit me 30 kursantë. Synimi i kursit është përgatitja e kursantëve si kryenënoficerë kompanie dhe si specialistë në shtab.



Akademia e Forcave të Armatosura vijon turin e panairit "Work & Study" në çdo qytet të Shqipërisë.

AFA përmes këtij aktiviteti ofron për maturantët njohjen me 3 programet e studimit Bachelor sipas modelit "West Point" në Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, në mënyrë që t'iu mundësojë atyre marrjen e vendimit të duhur mbi ndjekjen e studimeve universitare dhe orientimin e tyre drejt një pune të sigurt dhe me trajtim financiar dinjitoz, që në ditën e parë të studimeve.

Akademia e Forcave të Armatosura mirëpret të gjithë maturantët, të cilët duan një arsim cilësor me standarde bashkëkohore.

Presidenti i Republikës, Sh. T. z. Bajram Begaj, i shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Arben Kingji, zhvilluan një vizitë në Komandën Strategjike të NATO-s për Operacionet, ku pati një takim kokë më kokë me Komandantin Suprem, Gjeneral Cavolin.

Siguria globale, siguria në rajonin e Ballkanit Perëndimor, roli i Shqipërisë si kontributor për paqen, sigurinë dhe orientimin euroatlantik të rajonit, si edhe fuqizimi i kapaciteteve ushtarake të Shqipërisë dhe kontributi i drejtpërdrejtë në NATO, ishin disa nga çështjet ku u fokusuan bisedimet mes palëve.

“Sot situata e sigurisë është përkeqësuar dhe konflikti në Lindjen e Mesme, si dhe agresioni brutal rus kundër Ukrainës, kanë tendencë të përhapen edhe në rajone të tjera. Situata në Ballkanin Perëndimor vijon të jetë e brishtë, gjë që na rikujton se sa mund e përpjekje duhet, që të mbrohen jo vetëm parimet demokratike, por edhe paqja dhe siguria e vendeve tona”, - u shpreh Presidenti Begaj.

Presidenti Begaj e siguroi Gjeneral Cavolin se: “Shqipëria do të jetë gjithmonë aty ku NATO do të ketë nevojë, sikundër e ka dëshmuar me prezencën e saj në misionet dhe operacionet e NATO-s në Afganistan, KFOR (Kosovë), Letoni, Bullgari dhe Irak”.

Më tej, Presidenti Begaj vlerësoi në veçanti investimin që NATO bëri në Bazën Ajrore të Kuçovës, duke theksuar se: “Shqipëria ofron dhe mirëpret angazhimin dhe investimin e NATO-s për të shndërruar portin e Porto Romano-s në një bazë detare të saj”.



Presidenti Begaj: Shqipëria, rol kontributor për paqen dhe sigurinë euroatlantike në rajon



“

Shqipëria do të jetë gjithmonë aty ku NATO do të ketë nevojë, sikundër e ka dëshmuar me prezencën e saj në misionet dhe operacionet e NATO-s në Afganistan, KFOR (Kosovë), Letoni, Bullgari dhe Irak”.

Në vijim të modulit “Operacionet në përgjigje të krizave”, kursantët e kursit të Lartë të Oficerit (KLO) zhvilluan ushtrim praktik dyditor mbi “Menaxhimin e emergjencave civile për situata të shkaktuara nga tërmeti”. Ata e realizuan temën të vendosur në funksionet e strukturës së Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, duke diskutuar mbi përdorimin e kapaciteteve operationale të deklaruar për vitin 2024, sipas planit të Ri kombëtar.

Kursantët e këtij kursi gjatë ushtrimit praktik aftësohen për procesin e planëzimit të operationeve për Emergjencat Civile me kohë të kufizuar, duke vepruar si një forcë e përbashkët e organizuar për detyrë (FPOD).

KLO zhvillon praktikën mbi “Menaxhimin e emergjencave civile për situata të shkaktuara nga tërmeti”



Përfundoi Kursi i Sigurisë Fizike dhe Menaxhimit të Municioneve

Përfundoi Kursi 2-javor i Sigurisë Fizike dhe Menaxhimit të Municioneve, niveli III, ku u trajnuan 6 kursantë nga FSK-së dhe 3 kursante të FA-së. Në ceremoninë e certifikimit të kursantëve ishin të pranishëm drejtori i Drejtorisë së SHPFA, gjeneral brigade Aleksandër Pando, zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Shkëlqim Çela, atasheu ushtarak i Kosovës, kolonel Enver Hoti, shefi i Zyrës ODC nënkolonel Adrian Liptrot. Qëllimi i këtij kursi ishte trajnimi i personelit të FA-së dhe FSK-së për menaxhimin e municioneve, në kuadër të standardizimit të njohurive sipas procedurave të NATO-s, duke bërë të mundur rritjen e bashkëpunimit ndërmjet FA-së dhe FSK-së si dhe standardizimin e stërvitjeve dhe operationeve të përbashkëta në terren.

Ky trajnim u drejtua nga instruktorë të FA-së dhe FSK-së dhe u monitorua nga instruktorët e palës amerikane, duke ndarë eksperiencën dhe profesionalizmin e tyre.

Mbështetja nga USEUCOM nëpërmjet kompanisë “Golden West” tregon qartë rëndësinë e trajnimit të vazhdueshëm të personelit, të cilët përballen me sfida të ndryshme në menaxhimin e municioneve.





GJENERAL (R) PIRO AHMETAJ,
EKSPERT PËR SK, RAJONIN DHE NATO-n,
ZV/PRESIDENT I KËSHILLIT TË ATLANTIKUT

NATO, mesazhe gjeostrategjike nga Baza Ajrore e Kuçovës



PËRZGJEDHJA E KËSAJ E BAZE NGA NATO, SIGURISHT LIDHET EDHE ME POZICIONIN GJEOSTRATEGJIK TË BAZËS SË KUÇOVËS, E CILA PREJ VITIT 1955 DERI NË 1992 KA SHËRBYER SI BAZË ME PESHË STRATEGJIKE, KRYESISHT PËR SHKAK TË MIG-ëve, QË EDHE PSE PËRTEJ MUNDËSIVE TË NJË VENDI MJERISHT TË IZOLUAR, PËR PROPAGANDËN E REGJIMIT KONSIDEROHESHIN SI “LEGJIONE KAMIKAZE” TË FUQISË AJRORE TË RPSSH-SË, PRA KUNDËR KAMPEVE TË IMPERIALIZMIT (USA/NATO) SI DHE REVIZIONISTËVE SOVJETIK (VARSHAVË), OSE EDHE TË DYJA SË BASHKU!

S iç është bërë e njohur, nëpërmjet një ceremonie të shtetit shqiptar, Aleancës Euroatlantike, SHBA-së, u inaugurua përfundimi i projektit të NATO-s për: “ndërtimin e Bazës Mbështetëse Ajrore të Kuçovës”.

Disa këndvështrime rreth mesazheve gjeopolitike, strategjike, operacionale dhe ndoshta ekonomike të këtij projekti, ose mbi prezencën, për herë të parë me instalime ushtarake në kohë paqe (Peace Establishment) të NATO-s në territorin e RSh:

Pikësëpari, për peshën gjeopolitike të këtij projekti mjafton të sjellim në memorien kombëtare, që jo rastësisht, përfundimi i këtij projekti u konfirmua nga Sekretari i Shtetit të SHBA-ve, z. Blinken, gjatë vizitës në Tiranë; Kjo pasi, si për çdo vend tjetër anëtar, prezenca (footprint) ushtarake në kohë paqe e NATO-s në territorin e Republikës së Shqipërisë, mbart jo vetëm mesazh strategjik për sigurinë kolektive (artikulli 5) por edhe për mbrojtjen e interesave gjeopolitike të Aleancës Euroatlantike (USA/NATO) në Rajon dhe Mesdhe. Për rrjedhojë, besoj se vendi i parë mes 31 vendeve anëtare të Aleancës që ka përfitime gjeopolitike është RSH!

Për më tepër, përzgjedhja e kësaj e baze nga NATO, sigurisht lidhet edhe me pozicionin gjeostrategjik të bazës së Kuçovës, e cila prej vitit 1955 deri në 1992 ka shërbyer si bazë me peshë strategjike, kryesisht për shkak të Mig-ëve, që edhe pse përtej mundësive të një vendi mjerisht të izoluar, për propagandën e regjimit konsideroheshin si “legjione kamikaze” të fuqisë Ajrore të RPSSH-së, pra kundër kampeve të imperializmit (USA/NATO) si dhe revizionistëve Sovjetik (Varshavë), ose edhe të dyja së bashku!

Por në situatën aktuale, ndërtimi i kësaj baze, ose prezenca në kohë paqe e NATO-s në territorin e RSH, sigurisht mbart edhe një “mesazh force” ndaj Rusisë - Putiniste dhe çdo vendi tjetër që vijon të shpërdorohet nga Kremli: “kush guxon të sulmojë ushtarakisht, jo vetëm integritetin territorial të Republikës së Shqipërisë, por tashmë edhe prezencën e NATO-s (siç është Baza Ajrore e Kuçovës), do të përballet dhe do të ndëshkohet në mënyrë shembullore nga fuqia e pakonkurueshme Ajrore e Aleancës së Atlantikut të Veriut”, që u konfirmua si e tillë në 1999, kundër makinerisë kriminale të Millosheviçit.

Nga ana tjetër, ndërtimi kësaj baze në territorin e RSH (edhe pse gjithsesi modeste), i jep peshë shtesë aftësive operacionale të NATO-s, por edhe garanci besimit publik te fuqia dhe vlerat e Aleancës për mbrojtjen e tërësisë territoriale në kuadër të Artikullit 5, por edhe në kuadër të mbështetjes së stërvitjeve dhe manovrave operacionale të NATO-s dhe Forcave Ajrore të RSH.

Për sa i përket përfitimeve ekonomike nga ndërtimi i kësaj baze, nuk janë as pjesë e ekspertizës, as qëllimi i këtij opinion. Megjithatë mund të përmend: “projekti ka nisur në 2018 me reciprokisht 50 milion euro nga fondi përbashkët i Aleancës (NATO Common Funds) si dhe 5 milion euro nga pala Shqiptare”, që ka edhe përgjegjësitë e vendit pritës (RSH) për: “shpronësimet, ndërtimin e perimetrit të sigurisë dhe rrugëve lidhëse, standardet e mirëmbajtjes së hangarëve, depozitave të karburantit, ndriçimit, kamerave të sigurisë si dhe të sensorëve të zbulimit përreth bazës”.

Mendoj se do të ketë efekte ekonomike, për komunitetin e biznesit në zonën e Kuçovës, përfitime që gjithsesi do të ndërvaren nga personeli aktiv ushtarak për sigurinë e bazës, operatorët, mirëmbajtjen si dhe kryesisht nga dinamika e aktiviteteve ushtarake, siç janë stërvitjet e NATO/USA (p.sh “Steadfast 2024”), apo të FARSH, etj., që mund të organizohen në këtë bazë.

Si ndër dëshmitarët teknik të reformës së mbrojtjes, më tej si Përfaqësues Kombëtar Ushtarak në Komandën Supreme të NATO-s (SHAPE), më duhet ta konfirmoj me përgjegjësi se “lista me të gjitha infrastrukturat strategjike” (bazat tokësore, detare dhe ajrore të RSH, përfshi Bazën Ajrore Kuçovës etj.) janë vënë vullnetarisht në dispozicion të Aleancës që mbas aplikimit të RSH për në programin e Partneritetin për Paqe në 1994 (PfP/NATO). Ndërsa për më tej, këtë listë e kemi dorëzuar zyrtarisht (në emër të RSH) në SHAPE

sipas një formulari standard (të detyruar) për secilën infrastrukturë të listës, mbas marrjes së ftesës së anëtarësimit në Samitin e Bukuresht, në prill 2008.

Në përmblendhje të sa më sipër, ndërtimin e kësaj baze të NATO/RSH e çmoj me interesa të larta gjeopolitike, strategjike, operacionale, ekonomike si dhe për besimin publik te fuqia dhe vlerat e Aleancës Euroatlantike. Ndërsa përtej përfitimeve, Tirana Zyrtare duhet të demonstrojë mirënjohje kombëtare dhe përgjegjësi shtetërore shtesë, duke përmblusur të gjitha detyrimet dhe standardet e Aleancës, të përcaktuara në marrëveshjen e SOFA-s për personelin aktiv të angazhuar në sigurinë fizike, elektronike si dhe përmirësimin e kulturës së bashkëpunimit me Forcat Ajrore të USA/NATO (Ramstein, Gjermani).

Nga ana tjetër, ky projekt jo vetëm zyrtarizon prezencën (footprint) e parë në kohë paqe të NATO-s në territorin e RSH por

edhe që demonstroi peshën gjeostrategjike si dhe konsistencën 15 vjeçare të RSH (prej anëtarësimit, 4 prill 2009) si anëtare serioze ndaj kërcënimeve dhe përgjegjësi të përbashkëta, pasi edhe në këtë rast: “Tirana Zyrtare demonstroi mbështetje të pa kushtëzuar ndaj projekteve për modernizimin e fuqisë ushtarake të Aleancës në interes të sigurisë kolektive (Artikulli 5) të 31 vendeve të NATO-s, mbrojtjen e vlerave dhe interesave Euroatlantike (USA/NATO); si dhe deri në fitoren “jo vetëm për Ukrainën”!

Së fundmi, duke iu uruar suksese personelit të Fuqisë Ajrore të NATO-s si dhe kolegëve Shqiptarë, e meritojnë po ashtu t’iu shprehim mirënjohjen projektuesve, kontribuesve për ndërtimin e kësaj baze si dhe domosdoshmërinë e përditësimit të mëtejshëm të Sistemit të Sigurisë dhe Mbrojtjes Kombëtare, duke modernizuar konceptin, strukturat, kapacitetet, balancat demokratike të pushteteve si dhe kulturën Euroatlantike të bashkëpunimit me NATO-n.

Nënat që lindën diktatorë



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Lindin apo bëhen diktatorë?!

Nënat janë qenia që sjell jetën mbi tokë, por cili është ndikimi në rritjen e krijesës së saj? Në kohëra të ndryshme kemi parë që qeniet humane të ndikuara nga jeta në familjet e tyre të sjellin pikërisht kaosin dhe dhunën që kanë përjetuar.

Të tillë kanë qenë dhe liderët që kanë drejtuar popujt e tyre drejt shfarosjes. Teksa njih fëmijërinë e tyre kupton derivatin e jetës pa ndjenja, gati shtazore dhe pse jo jetës amorfe të tyre.

Diktatorët nuk vijnë në botë me mustaqe dhe një pushkë në dorë.

Klara Hitler

Po të marrim një nga figurat e rëndësishme të historisë të njerëzimit Hitlerin.

Klara rridhte nga një familje e thjeshtë, nga një qytet i vogël pranë Austrisë. E përshkruanin si një nënë shumë punëtore e përkushtuar për familjen, energjike, e dashur, shumë e urtë, e qetë dhe shumë e devotshme.

E përshkruar si një grua punëtore, e përlurur dhe thellësisht fetare. Kur ishte vetëm 16 vjeç u martua me kushëririn e saj Alois Hitler. Familja pati tre fëmijë që vdiqën nga difteria para moshës dy vjeçare. Fëmija i katërt, Adolfi, lindi në pranverën e vitit 1889. Klara iu përkushtua familjes së saj dhe e kaloi jetën duke u kujdesur për fëmijët: Adolfin dhe Paulën. Në vitin 1907, katër vjet pas vdekjes së burrit të saj, Klara u diagnostikua me kancer në gji. Pas trajtimeve të gjata dhe të dhimbshme, eksperimenteve me shumë ilaçe dhe kura, ajo vdiq në fund të vitit. Vdekja e saj e shkatërroi krejtësisht Adolfin, me të cilën kishte lidhje shumë të fortë. Ai nuk arriti ta kapërcejë vdekjen e saj deri në fund të jetës. Lidhjet në familjen Hitler konsiderohen si një nga arsyet kryesore për atë që u bë dhe që u shndërrua Adolfi. Nga njëra anë babai i tij i pashpirt, barbar, i cili abuzonte me të dhe nënën e tij, nga ana tjetër ishte vetë Klara, e cila, përballë frikës duronte burrin e saj. I mbante fëmijët dhe i trajtonte me respekt dhe dashuri. Zbutja e vazhdueshme e ndjenjave të dikujt dhe ndërtimi i një imazhi imagjinar i vetvetes, sipas historianëve dhe psikologëve, lëshuan mizori mbi Adolfin, duke e kthyer atë në Fyrherin, tmerrin e botës.

Nëna e Hitlerit e shtypte të birin me kujdesin e tepruar dhe me idetë e saj të fiksuara. Mendohet se ai ka qenë “djali i llastuar i mamasë”. Në këtë rast, tiparet femërore mbizotëruan në tiparet mashkullore. Pra e kam fjalën, prania e mamave, dashuria e tyre dhe jo prania e baballarëve.

Në fëmijëri i ati e torturoi për vdekje në prani të Adolfit qenin e tij të preferuar. Kjo ishte një nga rastet që u bë shkak dhe një nga arsyet që Adolfi më vonë u diagnostikua me çrregullime obsesivo-kompulsive. E gjithë bota përreth tij i dukej armiqësore. Ai nuk ndihej i sigurt askund dhe kishte probleme me veten. Hitleri preferonte të luante me vajza dhe i pëlqente të ishte në shërbimin e tyre. Ai vuante nga orientimi i tij i pakuptueshëm seksual, kishte frikë të ekspozohej dhe kishte kompleks vetmie dhe tjetërsimi.

Akumulime të tilla shkaktojnë pa dyshim mizori. Vdekja e mamasë ishte një ngjarje thelbësore në biografinë shpirtërore të tij. Për Hitlerin kjo u bë një katastrofë për universin e tij personal. Hitleri e rrethoi nënën e tij, që po vdiste nga kanceri, me një kujdes të tillë që, ishte jashtë aftësive të tij. Diktatori gjithnjë mbante në dhomën e tij një fotografi të vjetër të nënës. Ndjenja e vetmisë dhe mendimi se mbi të rëndonte padrejtësia që i bëhej, nuk e la kurrë.

Hitleri nuk u pajis me arsimin e duhur. Disa historianë pohojnë se kjo ishte për shkak të zymtësisë, ashpërsisë dhe urrejtjes që kishte ndaj shkollës. Hitleri, ndryshoi shkollat njëra pas tjetrës pa mundur të përfundojë asnjërën prej tyre. Në librin e tij të famshëm, ai pohoi se kishte përvetësuar jo më shumë se 10% të



atyre që kanë mësuar të tjerët. Dhe e justifikonte veten se nuk donte të studionte se nuk kishte para dhe se duhej të punonte (gjë që nuk ishte e vërtetë, në të dy rastet gënjeshtër ishte një tipar patologjik). Hitleri duket se prej asaj kohe po grumbullonte urrejtje për njerëzit e shkolluar dhe inteligjencës. Në shënimet e tij, diktatori i quajti

mësuesit “majmunë dhe hajvanë”. Një tipar tjetër i zakonshëm i Hitlerit ishte arroganca e tij shumë e dhimbshme. Si fëmijë, u torturua nga fobi të shumta. Të gjithë studiuesit janë të mendimi që kur arriti moshën madhore, në karakterin e tij u formuan elemente të tipit psikologjik të diktatorit.

“

KLARA RRIDHTE NGA NJË FAMILJE E THJESHTË, NGA NJË QYTET I VOGËL PRANË AUSTRISË. E PËRSHKRUANIN SI NJË NËNË SHUMË PUNËTORE E PËRKUSHTUAR PËR FAMILJEN, ENERGJIKE, E DASHUR, SHUMË E URTË, E QETË DHE SHUMË E DEVOTSHME.

“

NË FËMIJËRI I ATI E TORTUROI PËR VDEKJE NË PRANI TË ADOLFIT QENIN E TIJ TË PREFERUAR. KJO ISHTE NJË NGA RASTET QË U BË SHKAK DHE NJË NGA ARSYET QË ADOLFI MË VONË U DIAGNOSTIKUA ME ÇRREGULLIME OBSE-SIVO-KOMPULSIVE. E GJITHË BOTA PËRRETH TIJ I DUKEJ ARMIQËSORE. AI NUK NDIHEJ I SIGURT ASKUND DHE KIShte PROBLEME ME VETEN.



Ekaterina Gelazde Zhugazhvili

Ekaterina lindi në familjen e një kopshtari fortesash në Gjeorgji. Babai i saj vdiq shumë i ri dhe megjithëse familja nuk kishte shumë para, nëna e birësuar e Ekaterinës arriti t’i jepte një edukim. Ekaterina u martua me Vasarion Dzhugashvili në moshën 17 vjeç. Fëmija i parë dhe dy të tjerët vdiqën shumë shpejt, dhe i treti ishte Jozefi. Vasarioni e braktisi familjen në 1890, pasi u bë i varur nga alkooli dhe rrihte gruan dhe të birin. Një grua e fortë dhe e rreptë si Ekaterina donte të siguronte të ardhmen e të birit, të cilin e donte pafund. Ajo ëndërroi që Jozefi të studionte dhe të bëhej prift, pavarësisht kundërshtimit të burrit të saj, i cili donte që i biri të trashëgonte zanatin e tij, këpucarinë dhe shpesh nuk e linte të shkonte në shkollë. Për të siguruar arsimimin e djalit, Ekaterina mësoi të qepte dhe filloi të punojë. Lidhja midis Stalinit dhe nënës ishte shumë e fortë, por ambiciet që drejtonin të gjitha veprimet e saj pasi ai u rrit, lanë gjurmë në mendjen e djalit.

Terrorizmi është kthyer në njollë të zezë e mijëvjeçarit të ri. Kjo njollë e përgjakshme po sjell shkatërrim në shoqërinë njerëzore. Për ta luftuar terrorizmin dhe për t’iu kundërvënë, duhet të njihen rrënjët e tij, jo vetëm në politikë dhe ekonomi, por edhe në shpirtin njerëzor.

Maria Alexandrovna Ulyanova

Një nga shkatërrimtarët ishte edhe diktatori Lenin. Ai vinte nga një familje normale, në të cilën babai ishte figura kryesore dhe kishte qëllime të larta në jetë. Nëse trau i shtëpisë i traditës familjare të Uljanovëve ishte shumë i lartë dhe i vështirë për t’u arritur nga fëmija, që në përgjithësi i dukej i pa arritshëm. Ky ishte saktësisht problemi i Vladimir Ulianov. I ati që qëndronte përballë tij ishte i paarritshëm fatkeqësisht.

Ishte më e lehtë të bëhej revolucionar dhe të shkatërronte gjithë botën se të përpiqej të arrinte babanë e tij. Në shtëpinë e Uljanovëve sundonte një atmosferë rivaliteti, përpjekja për arritje të mëdha në jetë, sikur ishin në gara me njëri-tjetrin. Babai, Ilia Nikolajevič bëri një karrierë të dukshme, u bë fisnik, këshilltar dhe mori Urdhrin e Shën Stanislaus nga Perandori Aleksandri III. Babai Uljanov mungonte në shtëpi për muaj të tërë, nuk ishte prezent e nuk merrte pjesë në edukimin e djemve dhe fëmijëve në përgjithësi. Ai vizitonte provincën e Simbirskut dhe kontrollonte nivelin e arsimit publik.


Nëna Maria Alexandrovna ishte një nënë-mësuese-edukatore “me orar të plotë” në kushtet e shtëpisë. Ajo ishte tërësisht e angazhuar në edukimin e fëmijëve. Ishte zonjë me vullnet të fortë, krenare dhe e mbyllur. Kështu e rriti i ati,

që ishte një burrë i fuqishëm dhe madje despot. Maria ishte e ftohtë si akulli, e egër, e cila pa asnjë dyshim nuk u martua me dashuri. U transmetoi fëmijëve metodat e edukimit të babait të saj, kultivoi tek ata vullnet dhe ndjenjën e epërsisë ndaj të tjerëve. Vladimiri i ngjante më shumë nënës se babait.

Edhe pse përfundoi shkollën me medalje ari, ai ishte një njeri i kufizuar dhe i mbyllur brenda kornizave. Edukimi i tij provincial, veçanërisht në sfondin e detyrave që iu caktuan. Kultura për të cilën Vladimir Uljanov kishte cilësi, u zëvendësua nga ideja e tij fantastike për “riorganizimin e botës”. Kjo ishte një tragjedi e zakonshme për të gjithë diktatorët dhe terroristët.

Historia vazhdon Saddam Husein

Sadam ishte fëmijë i padëshiruar. Fëmijëria e dhimbshme e Sadam Huseinit dhe diagnostikimi i rastit të presidentit irakian Sadam Husein ishte një narcizëm i dhimbshëm. Lindja e diktatorit u shënuar nga dy vdekje. Babai i tij, i cili ishte një fshatar i varfër, vdiq, ndërsa gruaja e tij ishte ende shtatëzënë. Babai i Sadamit vdiq nga kanceri menjëherë pasi vdiq vëllai i tij i madh. Prandaj, është e kuptueshme që nëna e tij Subha ra në depresion të thellë nervor. Ajo madje dëshironte ta abortonte fëmijën. Pasi nuk arriti, Subha



bëri disa përpjekje për vetëvrasje pa sukses. Ishte e vështirë për të, të kujdesej dhe ta ushqente me gji të porsalindurin, i kujtonte dy të vdekurit, burrin dhe djalin. Pra tre vitet e para të jetës së Sadamit kaluan në kujdesin e dajës së nënës.

Më pas, Subha u martua. Dukej se ishte fillimi i një fati më të mirë dhe për djalin. Mjerisht, njerku i tij, Ibrahim al-Hassan, doli se ishte një tiran kokëfortë, i egër, i pamëshirshëm, njerku e rrihte dhe tallej rëndë me të. Këto veprime krijuan tek Sadami një reagim tejet të dhimbshëm ndaj realitetit përreth tij. Që atëherë, ai nuk i bëri kurrë autokritikë vetes dhe ishte shumë mizor. Tabloja plotësohej nga uria e vazhdueshme e nënës së tij, dhe qëndrimi i neveritshëm i njerkut të poshtër. Uria ishte një fenomen i përditshëm për mamanë dhe për Sadamin. Sadami i urrente delet që duhej t’i kulloste çdo ditë. Kishte vetëm dy rrugë për të dalë nga ky ferr, dëshpërimi dhe shpresa, apo ëndrrat për lavdinë e ardhshme. Ai zgjodhi ëndrrat. Thuhet se njëherë të afërmit erdhën për të vizituar shtëpinë e tyre. Me ta ishte një djalë moshatar me Sadamin. Vizitori menjëherë filloi të mburrej se ishte në klasën e dytë dhe se mund të lexonte dhe të numëronte, madje shkroi emrin në rërë. Sadami i prekur thellë shkoi te Al Hassan me një kërkesë për ta dërguar në shkollë.

Puna mbaroi me rrahje të rëndë nga njerku, ky veprim e bëri djalin që më pas të ikte nga shtëpia. I arratisuri u strehua përsëri tek xhaxhai i tij Heyrallah. Ai ishte personi i tretë në fëmijërinë e tij që krijoi dhe formatoi karakterin e tij. Ëndrra e Sadamit për të mësuar të shkruante u shndërrua në një dëshirë të papërmbajtshme, por i shërbeu edhe për të sunduar mbi njerëzit. Xhaxhai u përpoq që të brumoste në kokën e nipit se ai ishte i destinuar për vepra të jashtëzakonshme. Trashëgimia nga fëmijëria dhe mënyra e rritjes së njerkut kishin reflektuar dukshëm në sjelljen e tij në shkollë. Në shkollë u konsiderua nxënësi më i dobët, por askush nuk guxoi ta tallte, djali shpesh kishte sjellje brutale. Gjatë kohës së shkollës, Sadami vodhi kapelën e një mësuesi dhe e grisi copa copa. Një herë tjetër ai u zu keq me një shok të klasës, nxori një thikë dhe gati sa e vrau.

Në moshën pesëmbëdhjetë vjeçare, Sadami ishte tronditur thellë nga vdekja e kalit të tij të dashur. Aq shumë sa krahu iu paralizua për disa muaj. Narcizmi i sëmurë i Sadam Huseinit u manifestua në disa aspekte, ai mbyllej në vetvete, kishte shumë probleme me veten, dhe nuk ndjente dhembshuri për të tjerët. U përpoq të arrinte qëllimet e tij me çdo kusht dhe ishte një sociopat i plotë. Sadami ishte paranojak, i bindur se rrethohej vetëm nga armiq. Ai i donte lojërat e mëdha, armët, pa të cilat nuk ndjehej i qetë. Presidenti irakian kishte shumë ngjashmëri me Osama bin Ladenin.

Diktatorët

Pavarësisht nëse ne ende i konsiderojmë ata njerëz të mëdhenj apo psikopatë të zakonshëm që dinin të përfitonin dhe e përdorën si “shans” historik për të nxirë fatin e kombeve të tëra, përfshirë edhe kombin e tyre, këta ishin diktatorët e mëdhenj të shekullit XX.

Mbeten një enigmë e madhe e pazgjidhur që ngjall kureshtjen e miliona njerëzve në të gjithë botën. Nëse i besojmë teorisë tashmë “të vjetruar” të Sigmund Freud, fëmijëria dhe makthi janë faktor i rëndësishëm në formimin e personalitetit.

Gjykoni vetë si ishte fëmijëria e tyre, vitet e para të jetës dhe sa shumë ndikoi në fatin e tyre dhe në fatin e botës... Historia vazhdon...

Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

Flamuri suedez u ngrit në selinë e NATO-s për herë të parë, më 11 mars 2024 në një ceremoni për të shënuar anëtarësimin e vendit në Aleancë. Suedia u bë aleati i 32-të i NATO-s, më 7 mars, pasi depozitoi instrumentin e saj të pranimit në Traktatin e Atlantikut të Veriut me qeverinë e Shteteve të Bashkuara në Uashington D.C.

Sekretari i Përgjithshëm mirëpriti kryeministrin Ulf Kristersson në selinë e NATO-s, për ceremoninë e ngritjes së flamurit për të shënuar pranimin e Suedisë. Duke folur përpara të pranishmëve në ceremoni, Sekretari i Përgjithshëm falënderoi Kryeministrin Kristersson për udhëheqjen e tij të fortë personale dhe angazhimin e Suedisë në NATO. Ai tha se: “Suedia ka zënë vendin e saj të merituar në tryezën e NATO-s nën mburojën e Nenit 5, garancia përfundimtare e lirisë dhe sigurisë sonë. Të gjithë për një dhe një për të gjithë.”

Flamuri i Suedisë u ngrit për t’u bashkuar me flamujt e 31 aleatëve të tjerë, ndërsa u luajt himni kombëtar suedez dhe himni i NATO-s. Ceremonitë e ngritjes së flamurit suedez u zhvilluan njëkohësisht në Operacionet e Komandës Aleate (SHAPE) në Mons (Belgjikë) dhe Komandën Aleate të Transformimit në Norfolk, Virxhinia (SHBA). Duke qëndruar përkrah kryeministrit Kristersson, Sekretari i Përgjithshëm tha se: “Aderimi i Suedisë tregon sërisht se dera e NATO-s mbetet e hapur. Askush nuk mund ta mbyllë. Çdo komb ka të drejtë të zgjedhë rrugën e tij dhe ne të gjithë zgjedhim rrugën e lirisë dhe demokracisë”.

Duke vënë në dukje se NATO do të shënojë 75-vjetorin e saj këtë vit, Stoltenberg nënvizoi se lidhja transatlantike midis Evropës dhe Amerikës së Veriut ka siguruar lirinë dhe sigurinë tonë. Suedia do të ndihmojë në ndërtimin e një NATO edhe më të fortë në një kohë kritike për sigurinë euroatlantike, tha ai, duke shtuar se “bashkimi me NATO-n është i mirë për Suedinë, i mirë për stabilitetin në veri dhe i mirë për sigurinë e të gjithë Aleancës sonë”.

Pranimi i Suedisë tregon sërisht se dera e NATO-s mbetet e hapur

“Kjo është një ditë historike”, përshëndeti të pranishmit me fjalën e tij Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, në krah të Kryeministrit të Suedisë, Ulf Kristersson, në ceremoninë e ngritjes së flamurit, që shënoi pranimin e Suedisë në NATO. “Ne e mirëpresim Suedinë në NATO, në një kohë kritike për sigurinë tonë të përbashkët. Në të njëjtin moment, ne do të ngremë flamurin suedez këtu në selinë e NATO-s dhe në të gjithë Aleancën për herë të parë, tridhjetë e dy flamuj që valëviten së bashku. Ata përfaqësojnë tridhjetë e dy kombe që punojnë për një qëllim të përbashkët: Për të mbrojtur një miliard njerëz, parandaluar luftën dhe ruajtur paqen. Anëtarësimi i Suedisë e bën NATO-n më të fortë, Suedinë më të mbrojtur dhe ne të gjithë më të sigurt”, - tha Stoltenberg. “Suedia sjell aftësi të nivelit të lartë, Forcat ushtarake të klasit të parë dhe shpenzon më shumë se 2 për qind të PBB-së për mbrojtje. Pranimi i Suedisë tregon sërisht se dera e NATO-s mbetet e hapur. Askush nuk mund ta mbyllë. Çdo komb ka të drejtë të zgjedhë rrugën e tij. Dhe ne të gjithë zgjedhim rrugën e lirisë dhe demokracisë. Populli trim i Ukrainës po lufton për këto vlera ndërsa flasim”, - tha Shefi i NATO-s.

“Për 75 vjet, lidhja transatlantike midis Evropës dhe Amerikës së Veriut ka siguruar lirinë dhe sigurinë tonë. Si një mik dhe një fqinj nordik, më jep krenari të madhe që Suedia tani na bashkohet në këtë mision thelbësor. Sot, ndërsa ngremë flamurin suedez, qëndrojmë së bashku në unitet dhe solidaritet. Të përkushtuar për të siguruar dhe mbrojtur njëri-tjetrin. Të gjithë për një, dhe një për të gjithë”, - tha Sekretari i Përgjithshëm. Ai falënderoi Kryeministrin Kristersson, për angazhimin e tij personal ndaj Aleancës Euroatlantike dhe vlerësoi rolin kritik të ish-kryeministren Magdalena Andersson në aplikimin për anëtarësim në NATO. “Më vjen mirë që të dy jeni këtu me ministra dhe liderë të tjerë politikë bashkë me të gjithë ne sot. Kjo pasqyron mbështetjen e gjerë politike për NATO-n në shoqërinë suedeze. Kështu që të gjithë suedezëve u them: “Velkommen til NATO! Mirë se vini në NATO!”.

Suedia zë vendin e saj të merituar në tryezën e NATO-s

Edhe në deklaratën e përbashkët për shtyp që Sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg mbajti me Kryeministrin e Suedisë, Ulf Kristersson, theksoi edhe njëherë se: “Është nder t’ju mirëpres sot në selinë e NATO-s, sepse kjo është me të vërtetë një ditë historike”. E ndërsa tha se flamuri suedez do të ngrihej në selinë e NATO-s dhe në të gjithë Aleancën, si vend anëtar i tridhjetë e dytë i NATO-s, Stoltenberg tha se: “Suedia ka zënë vendin e saj të merituar në tryezën e NATO-s nën mburojën e mbrojtjes së Nenit 5, garancia përfundimtare e lirisë dhe sigurisë sonë”. Në deklaratën e përbashkët ai tha se anëtarësimi në NATO është i mirë për Suedinë, për stabilitetin në veri dhe gjithashtu për sigurinë e të gjithë Aleancës. “Suedia ka qenë prej kohësh një partner. Tani ju jeni një aleat me të gjitha përfitimet dhe përgjegjësitë që sjell kjo.

Flamuri suedez ngrihet në selinë e Aleancës: Askush nuk mund ta mbyllë derën e NATO-s



Suedia ka aftësi të avancuara, forca të armatosura të klasit të parë dhe industrinë e mbrojtjes, dhe shpenzon më shumë se 2 për qind të PBB-së në mbrojtje”.

“Ndërsa flasim, trupat suedeze po marrin pjesë në ‘Steadfast Defender’, stërvitjen më të madhe ushtarake të NATO-s që nga Lufta e Ftohtë. Një demonstrim i unitetit dhe vendosmërisë sonë. Në përgjigje të luftës së agresionit të Rusisë kundër Ukrainës, NATO ka rritur ndjeshëm praninë në të gjithë Aleancën dhe anëtarësimi i Suedisë e rrit këtë edhe më tej. Kur presidenti Putin nisi pushtimin e tij të plotë dy vjet më parë, ai donte më pak NATO dhe më shumë kontroll mbi fqinjët e tij. Ai donte të shkatërronte Ukrainën si një shtet sovran. Por ai dështoi”, - tha Stoltenberg.

“NATO është më e madhe dhe më e fortë. Ukraina është më afër anëtarësimit në NATO se kurrë më parë dhe ndërsa ukrainasit e guximshëm vazhdojnë të luftojnë për lirinë e tyre, ne qëndrojmë në krah të tyre. Aleatët vazhdojnë të shpallin miliarda dollarë ndihma të reja, duke përfshirë paketën më të madhe të Suedisë deri më tani, që mbulon municionet, mbrojtjen ajrore dhe anijet luftarake. Mbështetja jonë për Ukrainën shpëton jetë dhe ajo duhet të vazhdojë. Presidenti Putin filloi këtë luftë dhe ai mund ta përfundojë atë sot, por Ukraina nuk e ka këtë mundësi. Dorëzimi nuk është paqe”, - tha Sekretari i Përgjithshëm. “Ne duhet të vazhdojmë të forcojmë Ukrainën për t’i treguar Presidentit Putin se ai nuk do të marrë atë që dëshiron në fushën e betejës, por duhet të ulet dhe të negociojë një zgjidhje, ku Ukraina të njihet dhe të mbizotërojë si një komb sovran dhe i pavarur. Mbështetja e gjerë në të gjithë spektrin politik në Suedi e ka bërë të mundur këtë ditë. Pas më shumë se 200 vjet neutraliteti, ju po i bashkoheni aleancës ushtarake më të fortë dhe më të suksesshme në histori. Pra, mirë se erdhët në NATO”, - përfundoi deklaratën e tij Stoltenberg.

NATO më e fortë me Suedinë si

një aleat i plotë sesa si një partner i ngushtë

Më në fund flamuri suedez në selinë e NATO-s. Duke folur për emocionet personale për anëtarësimin e Suedisë, si një proces i shpejtë, por në të njëjtën kohë më i vështirë nga sa pritej, Sekretari i Përgjithshëm tha edhe për gazetarët, kur u pyet, se kjo është një ditë e madhe dhe një ditë historike gjithashtu. “Është e rëndësishme për Suedinë, është e rëndësishme për NATO-n, por është e rëndësishme edhe për mua personalisht. Suedia është e veçantë për mua, pjesërisht sepse Suedia për shumë vite ka qenë një partner i ngushtë, por edhe sepse si norvegjez sigurisht që jam fqinj dhe e kam ndjekur nga afër Suedinë për shumë, shumë vite. Dhe kur fillova si Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s në vitin 2014, isha i vetëdijshëm se disa vende në Evropë po aplikonin për anëtarësim, vende si Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut. Jam shumë i nderuar që jam Sekretari i Përgjithshëm që ka lehtësuar anëtarësimin për këto dy vende. Por nuk e prisja aspak që Finlanda dhe Suedia do të ishin anëtare gjatë mandatit tim si Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s. Por kjo ndryshoi totalisht me pushtimin në shkallë të plotë të Ukrainës dhe që atëherë, gjërat lëvizën shumë shpejt”, - tha ai. “Më kujtohet gjithashtu se fola me Ulf Kristersson, ai atëherë ishte në opozitë, në konferencën “Folk och Försvar”, dhe fillova të flas me politikanë të tjerë nordikë,

suedeze dhe finlandeze për mundësinë e aplikimit për anëtarësim. Më pas u morën vendimet dhe ne patëm mbështetje shumë të gjerë nga i gjithë spektri politik, si në Finlandë ashtu edhe në Suedi, që e bëri të mundur këtë. Kjo është sigurisht e mrekullueshme dhe kjo tregon gjithashtu se dera e NATO-s është e hapur. I takon aleatëve të NATO-s dhe vendit aplikues të vendosin, nuk i takon Rusisë të vendosë se cilën rrugë duan të zgjedhin vende të ndryshme evropiane. Suedia dhe Finlanda kanë zgjedhur të jenë anëtare të NATO-s dhe unë e mirëpres shumë këtë”, - tha Stoltenberg.

“Suedia, si anëtare e NATO-n përqafton të gjitha politikat e Aleancës në tërësinë e saj, të gjitha aftësitë e saj, në “perspektivën 360 gradë”, të mënyrës të funksionimit të NATO-s”, - tha më pas Kryeministri suedez Ulf Kristersson, teksa iu përgjigj interesit të gazetarëve në lidhje me armët bërthamore. “Ne nuk kemi asnjë hezitim kur bëhet fjalë për këtë. Ne e kuptojmë plotësisht nevojën për të gjitha aftësitë mbrojtëse të NATO-s, duke përfshirë strategjinë bërthamore. Nga ana tjetër, ne e themi qartë se nuk shohim nevojë që Suedia të mbajë baza të përhershme ose armë bërthamore në tokën suedeze në kohë paqeje. Ky është një vendim suedez, duke u respektuar plotësisht”, - tha ai.

Të njëjtën gjë tha edhe Sekretari i Përgjithshëm teksa konfirmoi se nuk ka plane për të zgjeruar numrin e vendeve, aleatëve të NATO-s, me armë bërthamore. “Ne vazhdimisht vlerësojmë qëndrimin tonë kur bëhet fjalë për forcat konvencionale. Por nuk ka plane për, për shembull, një grup beteje në Suedi siç kemi në vendet baltike. Mendoj se ajo që duhet të kuptojmë është se fakti që tani Suedia dhe Finlanda janë anëtarë të plotë të Aleancës është i mirë për të gjithë NATO-n, por është veçanërisht i mirë dhe i rëndësishëm për rajonin nordik dhe rajonin e Baltikut”. NATO për një kohë të gjatë është fokusuar “në dobësitë dhe sfidat”, për të përforcuar praninë e saj në rajonin e Baltikut dhe në vendet baltike.

Me Finlandën dhe Suedinë në Aleancë, gjeografia ndryshon, sepse NATO tani ka dy aleatë të rëndësishëm, por dhe në anën perëndimore të Detit Baltik. “Ne po ushtrohemi, po përgatitemi, do të kemi plane, natyrisht, për të mbrojtur Finlandën dhe Suedinë, por gjithashtu për të ndihmuar edhe në një mënyrë më efikase dhe më të fortë për të mbrojtur të gjitha rajonet e Baltikut”. Stoltenberg tha se nuk ka plane për ndonjë bazë të përhershme. “Ky është një vendim suedez që do të merret nëse kjo është diçka që ata do ta konsiderojnë në të ardhmen”, - tha ai.

Lidhur sulmet kibernetike, apo kërcënimet hibride të Rusisë, dhe se si ajo do të reagojë “nëse Suedia bëhet anëtare e NATO-s”, Kryeministri Kristersson tha se, duhet të qëndrojnë vigilentë dhe ishte shumë i sigurt se Rusia do të vazhdojë ta bëjë këtë. “Nuk duhet të jemi naivë dhe mendoj se jemi më të vetëdijshëm për rreziqet që na paraqiten tani më shumë sesa kurrë më parë. Pra thjesht qëndrojmë vigilent.”

Sekretari i Përgjithshëm gjithashtu tha se aleatët e NATO-s duhet të jenë gjithmonë të përgatitur e vigilentë kur bëhet fjalë për sulmet e mundshme kibernetike ruse, sulmet hibride, përpjekjet për të detyruar vendet në Evropë. “Ne e kemi parë këtë si kundër aleatëve të NATO-s dhe aleatëve jo-NATO. Lidhur me sulmet kibernetike kundër Suedisë ai tha se nuk janë asgjë e re, pasi ky ka qenë një rrezik i përhershëm prej vitesh edhe kur Suedia ishte jashtë NATO-s. Ne nuk shohim ndonjë kërcënim të afërt ushtarak kundër ndonjë aleati të NATO-s, pjesërisht sepse Rusia është kaq e preokupuar me luftën e agresionit kundër Ukrainës, por edhe sigurisht, sepse NATO është atje. NATO është atje për të siguruar që çdo kundërshtar i mundshëm të kuptojë se një sulm ndaj një aleati do të shkaktojë një përgjigje nga e gjithë Aleanca”. Qëllimi i NATO-s është të mos provokojë konflikt, të parandalojë luftën, të ruajë paqen. NATO e ka bërë këtë me sukses për 75 vjet, madje edhe gjatë periudhave më të ftohta të Luftës së Ftohtë, për të parandaluar ose ruajtur paqen duke hequr çdo hapësirë për llogaritje të gabuara ose keqkuptime me Moskë rreth gatishmërisë sonë për të siguruar dhe mbrojtur të gjithë aleatët. Suedia është më e sigurt brenda NATO-s sesa jashtë NATO-s. NATO është më e fortë me Suedinë si një aleat i plotë sesa Suedia si një partner i ngushtë. Pra, kjo është një ditë e mirë për Suedinë, një ditë e mirë për NATO-n dhe një ditë e mirë për sigurinë dhe stabilitetin në të gjithë Evropën”.



VERI TALUSHLLARI
ISH-SKËNDERBEGAS, 1971-1975

Drejt 80-vjetorit 'Skënderbegas'



Histori, Gjeografi, Fizikë, Kimi dhe lëndë të tjera. Sepse Shkolla "Skënderbej" vepronte me programet mësimore të Ministrisë së Arsimit, plus përgatitja speciale ushtarake. Prandaj nuk është e rastit që skënderbegasit që shkonin për llogari të Ministrisë së Mbrojtjes në Universitetin e Tiranës, në degë të tilla si Letërsi, Ekonomi, Inxhinieri, Mjekësi etj., dilnin me rezultate të larta. Po përmend këtu pak emra për ilustrim, duke u kërkuar

falje qindra kolegëve të tyre, po aq të suksesshëm. E dinë lexuesit se një nga ata që thirren si "bisturi e artë", kirurgu Ismail Feta, ka qenë skënderbegas? Siç ka qenë skënderbegas Dr. Mantho Nakuçi, ikona e dermatologjisë shqiptare. Siç kanë qenë skënderbegas edhe Sabri Godo e Fatmir Haxhiu, Kujtim Çako dhe Anastas Angjeli, Ilir e Zenel Shalari, Pandi Zguro, Arben Duka, Lulëzim Bilbili, Xhafer Qamirani, Hasan Çipuri, Bashkim Myhedini, Thanas Tane, Hysni Millosi, Roland Qafoku... dhe sa e sa të tjerë. Nuk po përmend kuadrot e lartë ushtarakë, komandues njësisish dhe drejtues të lartë ushtarakë, deri Shefa të Shtabit të Përgjithshëm, profesorë dhe pedagogë të Akademisë dhe Shkollave të Larta Ushtarake.

Çfarë duhet të bëjmë këtë 80-vjetor

Hapi i parë do të ishte një takim i Kryetarëve të Shoqatave të Ushtarakëve dhe krijimi i një komisioni, ku të angazhohen figura vërtet përbashkuese, si Presidenti Alfred Moisiu, Gjeneral Perlat Sula dhe emra të këtij kalibri. E kam shkruar edhe diku tjetër se asgjë nuk na ndan, asgjë nuk do të marrim me vete, (jeta bën të vetën dhe radhët tona po rrallohen), gjithçka na bashkon e së pari fakti që jemi betuar mbi një Flamur për t'i shërbyer Atdheut. Na bashkon fakti që kemi sakrifikuar rininë, gjithë vitet tona më të bukura larg familjeve, larg prindërve, maleve e fushave të Shqipërisë. Na bashkon fakti që kemi qenë pjesë e Ushtrisë më moderne që shqiptarët kanë patur në gjithë historinë e tyre mijërvjeçare. Dhe në përgjigje të atyre që hedhin gurë e baltë mbi ne dhe Ushtrinë ku ne shërbyem, na bashkon krenaria që për 50 vjet askush nuk guxoi të vinte në rrezik ekzistencën e shtetit shqiptar, të lirisë dhe rendit kushtetues. Përtej politizimeve, ne mbajtëm me nder fjalët që shqiptuam në Betimin Ushtarak.

***Autori është
zëvendës president
i Shoqatës së
Ushtarakëve
Shqiptarë
"SKËNDERBEJ
USA", në Nju Jork.**



Marsi që vjen, më 2025, shënon 80-vjetorin e hapjes së Shkollës së Mesme Ushtarake "Skënderbej". Një Shkollë që tani i përket historisë, pasi funksionoi vetëm 47 vjet. Por mjaftueshëm për ta shkruar emrin me germa ari në dy nga shtyllat ku mbahet Kombi dhe Shteti: Në Historinë e Ushtrisë më moderne që shqiptarët kanë patur në shekuj dhe Historinë e Arsimit shqiptar, posaçërisht atij të Mesëm të Përgjithshëm e atij Profesional.

Të gatshëm për të sharë e mohuar gjithçka të ngritur e të ndërtuar në regjimin e kaluar, edhe ndaj asaj Shkolle nuk kanë munguar nëmat e gurët, madje as ironitë e sarkazmat. Por ne nuk do të merremi shumë me to, megjithëse është e pamundur të kalohen krejt në heshtje. Por do të themi diçka për vlerat dhe vendin që Shkolla jonë zë në Historinë e Ushtrisë dhe të Arsimit Shqiptar.

Shkolla "Skënderbej", në kuptimin sa figurativ aq dhe real, i ka themelet te Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar dhe Ushtrisë NÇ kundër nazi-fashizmit dhe bashkëpunëtorëve të tyre, si pjesë e Frontit Antifashist Botëror dhe Aleancës Antifashiste Anglo-Sovjeto-Amerikane.

Ajo lindi pikërisht në atë kohë, mes krismave të armëve, kur flamujt e fitores nuk ishin ngritur ende mbi Rajshtag. Realisht sepse në bankat e asaj Shkolle, në ditën e parë, u ulën partizanë, djem dhe vajza luftëtarë të moshës 12-15 vjeç, për të cilët drejtuesit e Ushtrisë dhe të pushtetit që po lindte nga Lufta, menduan me të drejtë se lufta e tyre e ardhshme ishte dija. Ishte një shkollë në kushte lufte e paslufte, me kushtet më minimale për jetesë e mësimdhënie, por me shikim nga e ardhmja. Hapja e Shkollës së Pionierëve të Luftës, (Shkolla mori emrin "Skënderbej" në vitin 1947), më 28 mars 1945, është një akt shtet-formues dhe arsimdashës.

Në momentin që kjo Shkollë u mbyll, në gusht të vitit 1992, në bankat e saj kishin kaluar rreth 35 mijë nxënës. Shkolla "Skënderbej" ishte burimi kryesor për tre Shkollat e Larta Ushtarake, Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve "Enver Hoxha" në Tiranë, Shkollën e Aviacionit dhe atë të Marinës, këto të fundit në Vlorë, për të gjitha specialitetet, armët e shërbimet që kishte nevojë Ushtria. Por nga bankat e asaj Shkolle, veç oficerëve të Ushtrisë, kanë dalë figura të shquara në të gjitha fushat e jetës shoqërore, shkencore, kulturore e sportive të vendit tonë. Jo vetëm drejtuesit e lartë të njësive e reparteve ushtarake, por skënderbegas kanë qenë edhe politikanë, mjekë, shkrimtarë, sportistë, gazetarë, diplomatë, artistë, pedagogë, juristë.

Si çdo institucion shoqëror, shtetëror, arsimor etj., edhe Shkolla "Skënderbej" pati procesin e vet të rritjes e zhvillimit, pasurimit e përsosjes, pati probleme, vështirësi, suksese, dështime, arritje... E pra, edhe ajo nuk mund të mos ishte një pasqyrë e vetë shoqërisë shqiptare. Por duke parë bilancin e arritjeve të asaj Shkolle, e sidomos boshllëkun që ajo ka lënë në këto më se 30 vjet pas aktit banditesk, përbuzës, antiarsimor, antikulturor, antikombëtar të mbylljes së atij burimi kuadros që Shqipërisë do t'i duheshin në fushën e Sigurisë Kombëtare, pa folur për fusha të tjera, them me bindje se ajo Shkollë i tejkaloi objektivat dhe shpresat, shkoi tej detyrimeve e mundësive të një Shkolle të Mesme. Në çdo stad të ngritjes dhe modernizimit të Ushtrisë Popullore, Shkolla "Skënderbej" kishte në gatishmëri një kontingjent nxënësish për të marrë përsipër ngritjen dhe funksionimin e një arme a shërbimi që Komanda e Përgjithshme, Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm planëzonin. Këmbësorët e parë, Aviatorët e parë, Detarët e parë, Artiljerët e parë, Kundërajrorët dhe Radiolokatorët e parë, Ndërlidhësit apo Xhenjerët e parë, Prapavijasit apo Tankistët e parë, Kimistët, Zbuluesit, Automobilistët... të gjithë kanë qenë skënderbegas. Dhe pas të parëve, brezat vazhduan njëri pas tjetrit, edhe më të përgatitur, edhe më të ditur. Sepse programi mësimor erdhi duke u zhvilluar e përmirësuar, niveli i kërkesave ishte më i lartë, më i vështirë. Nuk mund të krahasohet p.sh., programi i vitit 1947 me atë të vitit 1974. Në vitin 1947 ishin kaluar programet e analfabetizmit dhe njohuritë ishin ato të nivelit nën të mesëm. Kurse në vitin 1974 ekipi përfaqësues i Shkollës "Skënderbej" në konkursin mes shkollave të mesme të Tiranës, padyshim ndër më të mirat në Shqipëri, i mundi të gjitha, doli në finale, dhe vetëm një vendim qesharak dhe absurd i ardhur "nga lart" ia hoqi fitoren, sepse binim në sy për keq po të fitonin ushtarakët(!). Konkursi përfshinte shkencat shoqërore dhe ato ekzakte, Letërsi,



Mihali Duri lindi në fshatin Erind të Lunxhërisë, Gjirokastrë, në vitin 1916. Pas vdekjes së të atit, ai bashkë me nënën dhe motrën më të vogël erdhi në Tiranë. Me të mbaruar shkollën fillore, hyri si punëtor në shtypshkronjën “Dielli”, ku punonte 10-12 orë në ditë, por paguhej shumë pak. Ai ishte i pajisur me veti të rralla të punëtorit revolucionar. Që në moshë të re hyri në lëvizjen punëtore dhe shumë shpejt u bë aktivist i dalluar. U lidh me Qemal Stafën, Vasil Shanton, Enver Hoxhën, Vojo Kushin etj. Mihali u bë anëtar i Grupit Komunist të Korçës, në degën e Tiranës. Këtu ai futi mjaft intelektualë revolucionarë, siç ishte bashkëfshatari i tij Misto Mame, i cili erdhi në Tiranë. Mihali dhe Misto ishin ata që krijuan shtypin ilegal që para themelimit të PKSH-së, duke shtypur trakte, parulla e artikuj për demaskimin e propagandës fashiste. Ata, përgatitën edhe shtypjen e gazetës “Zëri i popullit” dhe revistës “Kushtrimi i Lirisë”.

Për të realizuar këto, bënë një sërë aksionesh për sigurimin e shaptilografëve, makinave të shkrimit, letrës, shkronjave dhe mjeteve të tjera të nevojshme. Kryerjen e këtyre aksioneve ia ngarkuan Mihali Durit dhe njërit nga njësitet guerile të komanduar prej tij. Një nga këto aksione ishte ai që u bë në ish-Ministrinë Botore, ku u mor një sasi e madhe letre. Pas këtyre njësitit gueril me komandant Mihali Durin kreu shumë aksione të vështira, çka i alarmoi së tepërmi fashistët dhe vunë në lëvizje spiunët për survejimin e atentatorëve.

Mihali u pranua në radhët e PKSH-së që në themelimin e saj. Së bashku me Vasil Shanton, Qemal Stafën e luftëtarë të tjerë, ai ishte një nga partizanët e parë të vitit 1941, që u hodh në radhët e çetës së Pezës e komanduar nga patrioti Babë Myslimi, e cila u bë shumë shpejt e njohur në të gjithë vendin për aksionet dhe luftën e saj. Më 25 nëntor 1941, komunistët Vasil Shanto, Mihali Duri, Ferid Xhajko, Stavri Themelko, Pandi Nasho, Baki Starja, Loni Grazhdani etj., u mbledhën në Maknor dhe formuan celulën e parë të PK-së në çetën e Pezës, ku sekretar u zgjodh Mihali Duri. Nën udhëheqjen e Partisë, Peza u bë shkollë për përgatitjen e kadrove të rinj e të nevojshëm për të udhëhequr nga ana ushtarake dhe politike çetat partizane që u formuan më vonë në shumë krahina të vendit tonë.

Mihali Duri, si sekretar i celulës së PKSH-së në çetën e Pezës, dallohej për vendosmërinë dhe shpirtin e tij luftarak.

Në janar 1942, u mbledh në Tiranë aktivi i Partisë, ku u punua rezolucioni i formimit të PKSH-së. Ishin mbledhur 15-20 shokë në një shtëpi përdhese të një familjeje tiranase. Bënte shumë ftohtë. Ora po afronte 24.00 e natës. Mbledhja nuk po fillonte. Të gjithë ishin mbledhur pranë një mangalli me pak zjarr. Dukej se dikë pritnin. Dhe ja, u duk Enver Hoxha, bashkë me Vasil Shanton e Mihali Durin.

Mihali disa ditë para se të vritej erdhi në Tiranë dhe u takua me shokët e Komitetit Qarkor të PKSH-së të Tiranës për punët e luftës kundër fashistëve e spiunëve. Mbasi mbaroi punë, me dy shokë të qytetit shkoi në Pezë të Vogël ku ishte çeta e saj. Me të arritur atje, Mihali organizoi dhe përgatiti njerëz për të studiuar zbulimin e kazermave të Sharrës, që ishin të mbushura plot me municione e që duheshin djegur. Për t’ia arritur qëllimit, aty për aty, në Kodrën e Çorrit mbi Pezën e Vogël, ku qëndronte çeta, Mihali bashkë me komunistin Xhevdet Petrela përgatiti njësitin që do të bënte zbulimin dhe studimin e vendit, pastaj do të merrte masa për të kryer aksionin. Në zbulim u përgatitën të shkonin 6 vetë, Mihali me dy shokët e tij që e shoqëronin nga qyteti dhe Xhevdeti vetë i tretë. Ata u maskuan me rroba katundarësh dhe kaluan nëpër katunde si të panjohur. Rreth orën 5.00 të pasdites, njësit i u afrua në fshatin Damjan, ku gjendeshin shumë milicë dhe karabinierë të ardhur nga Tirana.

Tek po futeshin në shtëpitë e para, ata ranë në pritën e armiqve dhe lufta filloi. Pushka u ndez në gjithë fshatin. Partizanët u tërhoqën në rregull, duke luftuar në distancë të largët rreth 500 m. Milicët e dëndësuan shumë zjarrin e luftës kundër partizanëve që luftonin pa ndërprerje. Në këtë përpjekje plumbi armik e shkëputi Mihalit nga shokët dhe më 20 gusht 1942 ai ra dëshmor. Vrasja e tij qe një humbje e madhe për celulën e Partisë së çetës së Pezës dhe përgjithësisht të PKSH-së së Tiranës.

Myslim Peza në kujtimet e tij kujton: “Në çetën tonë erdhi Mihali Duri, një djalë i pashëm, me trup të fortë. Ishte azgan djalë, trim që s’mbahej, njeri i aksionit. Si sekretar i celulës së Partisë, Mihali u dallua edhe për gojëtarinë e tij të zjarrtë, për ta bërë sa më të kuptueshme për të gjithë njerëzit vijën e Partisë. Ai u dallua si një nga shokët tanë të çetës, nga më trimat, derisa u vra si Hero në fushën e luftës”.

‘Kush bie për atdhe, nuk vdes por ka le’



MIHALI U PRANUA NË RADHËT E PKSH-SË QË NË THEMELIMIN E SAJ. SË BASHKU ME VASIL SHANTON, QEMAL STAFËN E LUFTËTARË TË TJERË, AI ISHTE NJË NGA PARTIZANËT E PARË TË VITIT 1941, QË U HODH NË RADHËT E ÇETËS SË PEZËS E KOMANDUAR NGA PATRIOTI BABË MYSLIMI, E CILA U BË SHUMË SHPEJT E NJOHUR NË TË GJITHË VENDIN PËR AKSIONET DHE LUFTËN E SAJ.

Nënë Sillua e donte shumë Mihalit. Në kujtimet e saj të shtrenjtat për të birin, momenti i vrasjes së tij është shumë i rëndë, gati i papërballueshëm: “Ishte errësirë dhe thash të flija. Hoqa njërën çorape, po dëgjova të vinin disa makina përpara derës së shtëpisë dhe menjëherë filluan të trokiturat e forta: “Hape derën, hape derën sa do ta thyejmë!”. “Kush ini ju, - i pyeta e shqetësuar. - Jam plakë dhe mezi eci!”. “Hap derën”, - bërtisnin bishat, por nuk i numërova dot sa policë e milicë kishin ardhur. “Hajde, - më thanë, - se do të vish me neve në kuesturë”. Më morën dhe hipën në makinë. Rugës mendoja mos e kishin kapur dhe vrrarë Mihalit. Unë një natë më parë e përcolla dhe ai më tha: “Mos i beso askujt, edhe në qoftë se të thonë se unë jam vrrarë, pa më parë me sytë e

tu dhe mos trego asnjë nga shokët!”. Më zbritën nga makina, më vunë dritat ë sy, pastaj dritat i vunë tek një trup i hedhur përdhe dhe i tërhequr zvarrë. “Djali yt është ky?”, - më pyeti duke mu afruar kuestori i poshtër i quajtur Papalilo. U afrova dhe vura re se ishte Mihali, djali im i shtrenjtë. Iu afrova kuestorit dhe i thashë: “Po ky është djali im Ç’ m’i kini bërë kështu more të poshtër?!”. U afrova tek Mihali, i ngrita kokën dhe me gjakun e tij leva gjoksin tim...Vajta në shtëpi dhe qava shumë gjithë natën.

Presidiumi i Kuvendit Popullor i dha Mihali Durit dekoratën më të lartë “Hero i Popullit”. Ndërmarrjes ku shtypeshin librat dhe gazetatat iu vu emri “Mihali Duri”. Edhe një shkollë 9-vjeçare mban emrin e këtij hero i të lavdishëm.



ATDHEU përjetë mirënjohës, veprës tuaj

Viti 1997 do të mbetet në memorien e shqiptarëve si një vit i tmerrshëm dhe i përgjakshëm.

Mijëra të rinj humbën jetën pasi popullsia ishte e armatosur për shkak të hapjes së depove të armatimit. Shkodra, mbetet një prej qyteteve me bilancet më të rënda nga kjo 'luftë civile', por falë sakrificave të disa oficerëve të policisë dhe ushtrisë, situata nuk u përkeqësua edhe më tej, pasi populli mund të pajisej me granata apo raketa.

Të gjithë shkodranët mbajnë mend mbrëmjen e 12 marsit të vitit 1997, ditën kur qindra qytetarë u nisën drejt repartit ushtarak dhe baterisë kundër-ajrore që ndodhej në Dobraq, për të marrë armë. Atë mbrëmje të hidhur ranë dëshmorë të atdheut edhe 2 oficerët e ushtrisë, Muhamet Hasmuja dhe Arben Hoxha.

Muhamet Hasmuja, asokohe ishte 38 vjeç kapiten i parë, ishte emëruar komandant i bazës, ndërsa Arben Hoxha nga Elbasani ishte toger, oficer i këtij reparti. Kolegë të tyre, kujtojnë ditën e 12 marsit, ku po shërbenin dy oficerët.

"Rreth orës 12:00, pasi u inspektua baza kundër-ajrore në Dobraq për t'u njohur me masat që oficerët kishin marrë për mbrojtje, pasi ishte situatë problematike, Muhameti si drejtues kishte marrë masa shumë të mira dhe gjithçka ishte e organizuar ashtu siç e kërkonte protokollin.

Orët e mbrëmjes së 12 Marsit, u shoqëruan me sulmin e turmave ndaj reparteve ushtarake të Shkodrës. Rreth orës 19.30 minuta, ra Divizioni Ushtarak i Shkodrës, ku ishte e gjithë komanda e veriut. Urdhri ishte i qartë për drejtuesit e reparteve të tjera, që askush të mos përdorte armët, por të mbronin depot, zyrat dhe të gjitha godinat e ushtrisë.

Pak orë më vonë, sulmi vazhdoi drejt Dobraqit, aty ku ishte bateria kundër-ajrore me drejtues. Kur turmat mbërritën tek repartit, ata tentuan të thyejnë barrierat dhe të futen. Ushtarët dhe oficerët ishin në njërin krah me armë në duar, por pa urdhër për të qëlluar dhe në tjetrin krah turmat, ku mes tyre ishin edhe të armatosur. Në këtë situatë, Muhameti vendosi të futej në mes të turmës dhe oficerëve të tij për të shmangur përplasjet, pasi ushtarët ishin nën presion.

"Ai po u bënte thirrje qytetarëve që të largoheshin dhe situata të qetësohej. Në një moment, ai u rrëzua. Një dorë e



"PASOJA FATALE! FATKEQËSI TË JASHTËZAKONSHME. KEMI TË BËJMË ME TOPA KUNDËR-AJROR, RAKETA NË GATISHMËRI PËR ZJARR DHE TRITOL. NJË PAKUJDESI SADO E VOGËL, MADJE EDHE NJË CIGARE DO TË SHKAKTONTË SHPËRTHIMIN E TYRE, PA LLOGARITUR MË PAS NËSE DIKUSH DO TË AKTIVIZONTË TOPAT APO RAKETAT. PASOJAT DO TË ISHIN FATALE PËR MIJËRA NJERËZ".

zezë, nga turma qëllloi me armë drejt tij. Komandanti nuk u dëgjua më dhe u dha alarmi se Muhameti është qëlluar. Drejt tij u nisën oficerët Arben Hoxha dhe Agron Kodra për ta ndihmuar, por është dëgjuar një tjetër breshëri zjarri dhe të dy u rrëzuan", - tregon ish-shefi i Shtabit të Regjimentit kundër-ajror, Ndue Marku.

Arben Hoxha, oficeri nga Elbasani humbi jetën menjëherë, ndërsa oficeri tjetër Agron Kodra, u qëllua me 7 plumba, por për fatin e tij të mirë shpëtoi. Duke parë agravimin e situatës, ushtarët u detyruan që të qëllonin në ajër dhe të mbroheshin nga plumbat e turmave. Shkëmbimi i zjarrit ka vijuar deri rreth orës 3 të mëngjesit të 13 marsit, kur turmat janë tërhequr. Me një kamion, trupat e tyre janë transportuar për në spitalin e Shkodrës, ku janë njoftuar edhe familjarët. Arben Hoxha, u dërgua më pas në Elbasan tek familjarët e tij.

Por çfarë pasojash do të kishte për Shkodrën dhe Shqipërinë nëse repartit kundër-ajror nuk do të mbrohej deri në fund dhe do të ishte në duart e turmave?

"Pasoja fatale! Fatkeqësi të jashtëzakonshme. Kemi të bëjmë me topa kundër-ajror, raketa në gatishmëri për zjarr dhe tritol. Një pakujdesi sado e vogël, madje edhe një cigare do të shkaktonte shpërthimin e tyre, pa llogaritur më pas nëse dikush do të aktivizonte topat apo raketat. Pasojat do të ishin fatale për mijëra njerëz", - shpjegojnë ekspertët.

Në vitin 1998, Muhamet Hasmujën dhe Arben Hoxhën, Këshilli i Qarkut të Shkodrës i shpalli "Dëshmorë të Atdheut". Në nderim të tyre u ngrit edhe një obelisk tek ish-regjimenti kundër-ajror në Tepe.

Importet e armëve të Evropës pothuajse dyfishohen, Franca kalon Rusinë si eksportuesi i dytë më i madh në botë

Vendet evropiane pothuajse kanë dyfishuar importet e tyre të armëve midis viteve 2014-2018 dhe 2019-2023, duke rritur blerjet e tyre me 94% në periudhën e vëzhguar, sipas një studimi të ri nga Instituti Ndërkombëtar i Kërkimeve të Paqes në Stokholm (SIPRI).

Pjesa më e madhe e kësaj rritjeje ishte për shkak të transfertave të armëve në Ukrainë, e cila ende po lufton kundër pushtimit rus dhe e cila, midis 2022 dhe 2023, mori 23% të importit të armëve të rajonit në 2019-2023.

Dy vende evropiane - Franca dhe Italia - gjithashtu kanë rritur ndjeshëm eksportet e tyre në të njëjtën periudhë, duke gjetur blerës të gatshëm në Evropë, Azi dhe Lindjen e Mesme.

Ndoshta çuditërisht duke parë situatën aktuale në Evropë dhe në pjesën tjetër të botës, me konfliktet në Ukrainë dhe Gaza, vëllimi global i transfertave ndërkombëtare të armëve ra paksa me 3.3% midis 2014-2018 dhe 2019-2023.

Nga kush po blen armë Evropa?

Importuesi më i madh në Evropë ishte deri tani Ukraina, e cila përbënte 23% të të gjitha importeve të Evropës midis 2019 dhe 2023. Importuesit e radhës më të mëdhenj ishin Mbretëria e Bashkuar (11% e të gjitha importeve evropiane) dhe Holanda (9.0%).

Një shumicë prej 55% e importeve të armëve nga vendet evropiane midis 2019-2023 erdhi nga SHBA-ja, eksportet e të cilave në Evropë u rritën me 35% krahasuar me periudhën e mëparshme të analizuar, 2014-2018. Armët e tjera kryesore të importuara në Evropë midis 2019 dhe 2023 erdhën nga Azia, Oqeania dhe Lindja e Mesme.

“Shumë faktorë formësojnë vendimet e shteteve evropiane të NATO-s për të importuar nga SHBA-të, duke përfshirë qëllimin e ruajtjes së marrëdhënieve transatlantike së bashku me çështjet më teknike, ushtarake dhe të lidhura me koston”, - shpjegoi në një deklaratë për shtyp drejtori i SIPRI, Dan Smith. “Nëse marrëdhëniet transatlantike ndryshojnë në vitet e ardhshme, politikat e prokurimit të armëve të shteteve evropiane mund të modifikohen gjithashtu”.

Mbështetësit e radhës më të mëdhenj pas SHBA-së ishin Gjermania (6.4%) dhe Franca (4.6%).

Rritja e eksporteve të armëve të Francës

SHBA-ja dhe Franca aktualisht dominojnë eksportet globale të armëve, me Uashingtonin që ka rritur eksportet e tij me 17% midis 2014-2018 dhe 2019-2023 dhe Parisi me 47% në të njëjtën periudhë.

Vetëm SHBA-ja ishte përgjegjëse për 42% të totalit të eksporteve globale të armëve, duke shpërndarë armë në 107 shtete midis 2019 dhe 2023, më shumë se çdo eksportues tjetër i madh. Rritja e eksporteve franceze të armëve, nga ana tjetër, ishte kryesisht për shkak të dërgimit të avionëve luftarakë në Indi, Katar dhe Egjipt.



Për herë të parë, Franca ishte përpara Rusisë në listën e eksportuesve më të mëdhenj të armëve në botë, duke u renditur e dyta ku Rusia renditej e treta. Kjo për shkak se ndërsa eksportet e Francës u rritën, eksportet e Rusisë u përgjysmuan (-53%) në të njëjtën periudhë. Ndërsa Rusia eksportoi në 31 shtete në vitin 2019, numri ra në vetëm 12 në 2023.

Pjesa më e madhe e eksporteve të armëve të Francës (42%) shkoi në vendet e Azisë dhe Oqeanisë, ndërsa 34% e tjera shkuan në shtetet e Lindjes së Mesme.

Përfituesi më i madh i eksporteve franceze të armëve ishte India, me gati 30% të të gjitha eksporteve. Vendi ishte importuesi kryesor i armëve në botë midis 2019-2023, megjithëse furnizuesi kryesor i tij mbetet Rusia, e cila përbënte 36% të të gjitha importeve të saj.

“Franca po përdor mundësinë e kërkesës së fortë globale për të nxitur industrinë e saj të armëve përmes eksporteve”, - tha Katarina Djokic, një studiuese në SIPRI. “Franca ka qenë veçanërisht e suksesshme në shitjen e avionëve të saj luftarak jashtë Evropës”.

Vende të tjera, duke përfshirë një tjetër evropian, panë rritje të eksporteve të tyre të armëve në tre vitet e fundit. Në Itali, eksportet e armëve u rritën me 86%, ndërsa në Korenë e Jugut u rritën me 12%. Kina pati rënie të eksporteve të armëve me 5.3%, Gjermanisë dhe Britanisë së Madhe me 14%, Spanjës me 2.2% dhe Izraelit me 25%.

Kujt po i shet armë Evropa?

Së bashku me SHBA-në, Evropa Perëndimore përbënte 72% të të gjitha eksporteve të armëve në 2019-2023, ndërsa vetëm Evropa ishte përgjegjëse për rreth një të tretën e eksporteve globale të armëve, duke përfshirë vëllime të mëdha që dilnin jashtë rajonit.

Gjithsej pesë vende evropiane, me përjashtim të Rusisë, ishin në mesin e 10 eksportuesve më të mëdhenj në botë, duke përfshirë Francën (vendi 2), Gjermaninë (vendi 5), Italinë (vendi 6), Britaninë e Madhe (vendi 7) dhe Spanjën (vendi 8). Holanda ishte në vendin e 12-të, e ndjekur nga Suedia (13), Polonia (14), Zvicra (17), Ukraina (18), Norvegjia (19), Belgjika (22) dhe Bjellorusia (23).

Rreth 30% e transfertave ndërkombëtare të armëve shkuan në Lindjen e Mesme në 2019-2023, me tre blerësit kryesorë në rajon që ishin Arabia Saudite, Katari dhe Egjipti. Pjesa më e madhe e importeve të armëve nga shtetet e Lindjes së Mesme u furnizua nga SHBA (52%), e ndjekur nga Franca (12%), Italia (10%) dhe Gjermania (7.1%).

Importuesit më të mëdhenj në 2019-2023 ishin India, Arabia Saudite dhe Katari, e ndjekur nga Ukraina, e cila ka marrë transferime të mëdha armësh nga mbi 30 vende midis 2022 dhe 2023.

SHBA-ja dhe Gjermania përbënin përkatësisht 69% dhe 30% të importeve të armëve nga Izraeli, i cili aktualisht po lufton një luftë vdekjeprurëse kundër Hamasit në Gaza, e cila vrau mbi 30 000 njerëz, shumica e të cilëve ishin civilë.

Shkrim nga “Euronews”



50 Ekspertët: Si ta vëmë AI-në në shërbim të njerëzimit e jo njerëzimin në shërbim të AI-së

Ekspertët mbrojnë AI-në me në qendër njeriun, duke kërkuar dizajnimin e teknologjisë që mbështet dhe pasuron jetën njerëzore, në vend që t'i detyrojë njerëzit të përshtaten me të. Një libër i ri nga pesëdhjetë ekspertëve nga mbi dymbëdhjetë vende dhe disiplina, eksploron mënyra praktike për të zbatuar AI-në me në qendër njeriun, duke adresuar rreziqet dhe duke propozuar zgjidhje në kontekste të ndryshme.

Sipas një ekipi ekspertësh globalë, ne duhet të ndalojmë zhvillimin e teknologjisë së re të AI-së thjesht për hir të inovacionit, i cili detyron rregullime në praktika, zakone dhe ligje për të përshtatur teknologjinë. Në vend të kësaj, ata mbrojnë krijimin e AI-së që plotëson saktësisht nevojat tona, duke u përafruar me parimet e dizajnit të AI-së me në qendër njeriun.

Pesëdhjetë ekspertë nga e gjithë bota kanë kontribuar me punime kërkimore në një libër të ri se si ta bëjmë AI-në më “të përqendruar te njeriu”, duke eksploruar rreziqet dhe mundësitë e humbura të mospërdorimit të kësaj qasjeje dhe mënyrave praktike për ta zbatuar atë.

Ekspertët vijnë nga mbi 12 vende, duke përfshirë Kanadanë, Francën, Italinë, Japoninë, Zelandën e Re dhe Britaninë e Madhe, dhe më shumë se 12 disiplina, duke përfshirë shkencat kompjuterike, arsimin, ligjin, menaxhimin, shkencat politike dhe sociologjinë.

AI-ja me në qendër njeriun shikon teknologjitë e AI-së në kontekste të ndryshme, duke përfshirë bujqësinë, mjediset e vendit të punës, kujdesin shëndetësor, drejtësinë penale, arsimin e lartë dhe ofron masa të zbatueshme për të qenë më “të përqendruar te njeriu”, duke përfshirë qasjet për kutitë e rërës rregullatore dhe kornizat për punën ndërdisiplinore.

Çfarë është AI-ja me në qendër njeriun?

Inteligjenca artificiale (AI) përshkon jetët tona në një mënyrë gjithnjë në rritje dhe disa ekspertë po argumentojnë se mbështetja vetëm në kompanitë e teknologjisë për të zhvilluar dhe vendosur këtë teknologji në një mënyrë që rrit vërtet përvojën njerëzore, do të jetë e dëmshme për njerëzit në planin afatgjatë. Këtu hyn AI-ja me në qendër njeriun.

Një nga ekspertët më të shquar në botë për AI-në me në qendër njeriun, Shannon Vallor nga Universiteti i Edinburgut në Skoci, shpjegon se AI-ja me në qendër njeriun do të thotë teknologji që i ndihmon njerëzit të lulëzojnë.

Ajo thotë: “Teknologjia me në qendër njeriun ka të bëjë me përafrimin e të gjithë ekosistemit teknologjik me shëndetin dhe mirëqenien e personit njerëzor. Kontrasti është me teknologjinë që është krijuar për të zëvendësuar njerëzit, për të konkurruar me njerëzit ose për të zhvlerësuar njerëzit, në krahasim me teknologjinë që është krijuar për të mbështetur, fuqizuar, pasuruar dhe forcuar njerëzit.”

Ajo tregon për AI-në gjeneruese, e cila është rritur në popullaritet vitet e fundit, si një shembull i teknologjisë që nuk është në qendër të njeriut – ajo argumenton se teknologjia u krijua nga organizatat, thjesht duke dashur të shohin se sa të fuqishëm mund ta bëjnë një sistem, në vend që të plotësoni një nevojë njerëzore.

“Ajo që marrim është diçka me të cilën duhet të përballemi, në krahasim me diçka të krijuar nga ne, për ne dhe për të përfituar ne. Nuk është teknologjia që na duhet”, - shpjegon ajo. “Në vend që t'i përshtatim teknologjitë me nevojat tona, ne përshtatemi me nevojat e teknologjisë”.

Cili është problemi me AI-në?

Kontribuuesit në AI-në me në qendër njeriun shprehin shpresat e tyre, por edhe shumë shqetësime me AI-në tani dhe në trajektoren e saj aktuale, pa një fokus me në qendër njeriun.

Malwina Anna Wójcik, nga Universiteti i Bolonjës, Itali dhe Universiteti i Luksemburgut, thekson paragjykimet sistemike në zhvillimin aktual të AI-së. Ajo thekson se komunitetet e marginalizuara historikisht nuk luajnë një rol kuptimplotë në hartimin dhe zhvillimin e teknologjive të AI-së, duke çuar në “rrënjosjen e narrativave të pushtetit mbizotërues”.

Ajo argumenton se ka mungesë të të dhënave për minoritetet ose se të dhënat në dispozicion janë të pasakta, duke çuar në diskriminim. Për më tepër, disponueshmëria e pabarabartë e sistemeve të AI-së shkakton zgjerimin e boshllëqeve të energjisë, me grupet e marginalizuara të paafte për të hyrë në qarkun e të dhënave të AI-së dhe njëkohësisht të paafte për të përfituar nga teknologjitë.

Zgjidhja e saj është diversiteti në kërkime, si dhe projekte ndërdisiplinore dhe bashkëpunuese në ndërthurjen e shkencave kompjuterike, etikës, ligjit dhe shkencave sociale. Në nivel politikash, ajo sugjeron se nismat ndërkombëtare duhet të përfshijnë dialogun ndërkulturor me traditat joperëndimore.

Ndërkohë Matt Malone, nga Universiteti Thompson Rivers në Kanada, shpjegon se si AI-ja përbën një sfida për privatësinë, sepse pak njerëz e kuptojnë me të vërtetë se si mblidhen të dhënat

e tyre ose si përdoren ato.

“Këto boshllëqe të pëlqimit dhe njohurive rezultojnë në ndërhyrje të vazhdueshme në domene që privatësia mund të kërkojë të kontrollojë ndryshe”, - shpjegon ai. Privatësia përcakton se sa larg e lëmë teknologjinë të arrijë në sferat e jetës dhe ndërgjegjes njerëzore. Por ndërsa këto goditje zbehen, privatësia ripërcaktohet dhe rikonceptohet shpejt, dhe ndërsa AI-ja kap më shumë kohë, vëmendje dhe besim, privatësia do të vazhdojë të luajë një rol përcaktues në përcaktimin e kufijve midis njeriut dhe teknologjisë.

Malone sugjeron se “privatësia do të jetë në fluks me pranimin ose refuzimin e teknologjive të drejtuara nga AI” dhe se edhe pse teknologjia ofron barazi më të madhe, ka të ngjarë që individualiteti të jetë në rrezik.

AI-ja dhe sjellja njerëzore

Përveç eksplorimit të ndikimeve shoqërore, kontribuuesit hetojnë ndikimet e sjelljes së përdorimit të AI-së në formën e saj aktuale.

Oshri Bar-Gil nga Instituti i Kërkimeve të Shkencave të Sjelljes, Izrael, kreu një projekt kërkimor duke parë se si përdorimi i shërbimeve të “Google-it” shkaktoi ndryshime në veten dhe vetë-konceptin. Ai shpjegon se “vetja” e të dhënave krijohet kur ne përdorim një platformë, më pas platforma merr më shumë të dhëna nga mënyra se si e përdorim atë, pastaj përdor të dhënat dhe preferencat që ne ofrojmë për të përmirësuar performancën e saj.

“Këta motorë rekomandimi efikas dhe të dobishëm kanë një kosto të fshehur ndikimin e tyre tek ne si njerëz”, - thotë ai. “Ata ndryshojnë proceset tona të të menduarit, duke ndryshuar disa nga aspektet tona thelbësore njerëzore të qëllimshmërisë, racionalitetit dhe kujtesës në sferën dixhitale dhe botën reale, duke pakësuar autonominë tonë.”

Gjithashtu duke parë ndikimet në sjellje, Alistair Knott nga Universiteti Victoria i Wellington, Zelandë e Re dhe Tapabrata Chakraborti nga Instituti Alan Turing, University College London, MB dhe Dino Pedreschi nga Universiteti i Pizës, Itali, shikuan përdorimin e përhapur të AI-së, në mediat sociale.

“Ndërsa sistemet e AI-së të përdorura nga platformat e mediave sociale janë të përqendruara te njeriu në disa kuptime, ka disa aspekte të funksionimit të tyre që meritojnë një shqyrtim të kujdesshëm”, - shpjegojnë ata.

Problemi buron nga fakti se AI-ja vazhdimisht mëson nga sjellja e përdoruesve, duke rafinuar modelin e tyre të përdoruesve ndërsa ata vazhdojnë të angazhohen me platformën. Por përdoruesit priren të klikojnë mbi artikujt që sistemi rekomandues sugjeron për ta, që do të thotë se sistemi i AI-së ka të ngjarë të ngushtojë gamën e interesave të një përdoruesi me kalimin e kohës. Nëse përdoruesit ndërveprojnë me përmbajtje të njëanshme, ka më shumë gjasa që atyre t'u rekomandohet ajo përmbajtje dhe nëse vazhdojnë të ndërveprojnë me të, ata do ta shohin veten duke parë më shumë prej saj: “Me pak fjalë, ekziston një arsye e mundshme shqetësimi që sistemet e rekomanduesve mund të luajnë një rol në lëvizjen e përdoruesve drejt pozicioneve ekstremiste”.

Ata sugjerojnë disa zgjidhje për këto çështje, duke përfshirë

transparencë shtesë nga kompanitë që mbajnë të dhëna mbi sistemet rekomanduese për të lejuar studime dhe raportime më të mëdha mbi efektet e këtyre sistemeve, mbi qëndrimet e përdoruesve ndaj përmbajtjes së dëmshme.

Si mund të funksionojë në realitet AI-ja me në qendër njeriun?

Pierre Larouche nga Université de Montréal, Kanada, argumenton se trajtimi i AI-së si “një objekt i pavarur i ligjit dhe rregullimit” dhe supozimi se nuk ka “asnjë ligj të zbatueshëm aktualisht për AI-në” ka lënë disa politikëbërës të ndjehen sikur është një detyrë e pakapërcyeshme.

Ai shpjegon: “Meqenëse AI-ja shihet si një zhvillim i ri teknologjik, supozohet se ende nuk ekziston asnjë ligj për të. Në të njëjtën linjë, pavarësisht nga pamjaftueshmëria, nëse jo mungesa e plotë, e rregullave specifike në lidhje me AI-në si e tillë, nuk ka mungesë të ligjeve që mund të zbatohen për AI-në, për shkak të përfshirjes së saj në marrëdhëniet sociale dhe ekonomike.

Larouche sugjeron se sfida nuk është të krijohet legjislacion i ri, por të konstatohet sesi ligji ekzistues mund të zgjerohet dhe zbatohet për AI-në dhe shpjegon: “Të lejosh që debati të kornizohet si një diskutim etik pa fund mbi një faqe të zbrazët ligjore mund të jetë kundër-produktive për politikëbërjen, në masën që u hap derën taktikave të ndryshme vonuese të dizajnuara për të zgjatur diskutimin pafundësisht, ndërkohë që teknologjia vazhdon të përparojë me ritme të shpejta.

Benjamin Prud'homme, Zëvendës-Presidenti për Politikën, Shoqërinë dhe Çështjet Globale në Mila - Instituti i Inteligjencës Artificiale në Quebec, një nga komunitetet më të mëdha akademike kushtuar AI-së, i bën jehonë kësaj thirrjeje për besim te politikëbërësit.

Ai shpjegon: “Rekomandimi im i parë, ose ndoshta shpresa ime e parë, do të ishte që ne të fillojmë të largohemi nga dikotomia midis inovacionit dhe rregullimit, që ne e pranojmë se mund të jetë në rregull të mbytet inovacioni nëse kjo risi është e papërgjegjshme.

“Unë do t'u thoja politikëbërësve të jenë më të sigurt në aftësinë e tyre për të rregulluar AI-në; se po, teknologjia është e re, por është e pasaktë të thuhet se nuk janë përballur (me sukses) me sfidat e lidhura me inovacionin në të kaluarën, shumë njerëz në komunitetin e qeverisjes së AI-së kanë frikë se mos i bëjnë gjërat siç duhet që në fillim. Dhe ju e dini, një gjë që kam mësuar në përvojat e mia në qarqet politikëbërëse është se ne nuk do ta arrijmë plotësisht atë që nga fillimi. Është në rregull.

“Askush nuk ka një shkop magjik. Pra, unë do t'u thosha politikëbërësit si vijon: Merreni seriozisht çështjen. Bëni më të mirën që mundeni. Ftoni një gamë të gjerë këndvështrimesh, duke përfshirë komunitetet e marginalizuara dhe përdoruesit përfundimtarë në tryezë ndërsa përpiqeni të gjeni mekanizmat e duhur të qeverisjes. Por mos lejoji që të paralizoheni nga një grusht zërash që pretendojnë se qeveritë nuk mund të rregullojnë AI-në pa mbytur inovacionin. Bashkimi Evropian mund të japë një shembull në këtë drejtim, pasi Akti shumë ambicioz i AI-së, ligji i parë sistematik për AI-në, duhet të miratohet përfundimisht në muajt e ardhshëm.

14 marsi, Vera Shqiptare dhe kulti i saj

Dita e Verës është një festë me origjinë të lashtë. Festimi kryhet në nderim të natyrës së bukur shqiptare dhe bimësisë që merr jetë në këtë datë. Tashmë kjo festë është bërë edhe ditë kombëtare pushimi.

Shenja dalluese e këtij festimi është gatimi i ballokumeve. Në Lezhë, Ditën e Verës ndizeshin zjarre purifikues për t'i dhënë forcë diellit në oborr e në kopshte. Nga gratë bëheshin rite magjike kundër qenieve të tjera dëmtuese, grabitëse.

Ndonëse kjo ditë vazhdon të ruhet dhe festohet madhërisht në qytetin e lashtë të (VALMIT) Elbasanit, ajo është festë e të gjithë shqiptarëve. Dita e Verës ishte dita e fillimit të vitit sipas kalendarit shumë të lashtë të shqiptarëve, pra një ditë që kremtohej shumë shekuj para se të lindte krishterimi.

Ajo kremtohej më 1 mars të kalendarit Julian, ditën e parë të vitit të ri (sipas kalendarit Gregorian, 14 mars). Ajo ishte një festë mbarë shqiptare, që kremtohej si në Veri edhe në Jug, por me nuanca të ndryshme, sipas krahinave.

Rituali i Ditës së Verës, katër fazat e festës

Festa pagane ka ritualin e saj. Ritet janë trashëguar brez pas brezi ndoshta për 24 shekuj me radhë. Dikur dedikimet i kushtoheshin perëndeshës Dianë, sot ato praktikohen për një jetë më të mirë, të mbushur me gëzim, dashuri dhe begati...

Faza e parë është faza përgatitore që nis me grumbullimin e zahireve që janë të nevojshme për Ditën e Verës.

Faza e dytë është nata e Verës, që nis më 13 mars me zjarrin.

Faza e tretë është mëngjesi i Ditës së Verës, që nis me 14 mars dhe së fundi pikniku i Ditës së Verës në mesditën e 14 marsit.

Në vigjilje të natës së Ditës së Verës, çdo shtëpi është e mbushur me një gëzim të veçantë, është një ndjesi që i pushton njerëzit fare pa e kuptuar. Ndoshta nga ndikimi i diellit, gjelbërimit apo shpërthimit të farës dhe sythave që janë shprehje e begatisë dhe vazhdimësisë. Shtëpia mbushet plot me gjëra të mira dhe me bollëk.

Porta zbukurohet me lule dhe lastarë të gjelbër, të cilët simbolizojnë futjen e mirësisë dhe natyrës. Gjatë kësaj nate të afërmit, por edhe shokë e miq të ardhur nga viset e tjera, këndojnë këngë të vjetra të shoqëruar me kuzhinën me nam të Elbasanit. Disa nga gjellët, që nuk i gjen në vend tjetër, janë tava me pistil, tava e kosit, kabunia, çomleku, gjeli i detit etj. Gjatë kësaj nate fillon të ndahet edhe hiseja e nesërme për njerëzit më të afërm. Mëngjesi është i gëzuar dhe festiv. Elbasanasit zgjohen herët më 14 mars dhe me një përkushtim të veçantë hapin derën që të futet e mira dhe të dalë e liga.

“Buka e Derrit”

Sytë lahen me lulet e verës, me manushaqe dhe me karakaftë (lloj luleje) dhe me pas pihet ujë në “bukën e derrit”, që është një zhardhok që gjendet nën tokë në zonat me pyje dhe gjelbërim. Uji në “bukën e derrit” simbolizon një vit të shëndetshëm dhe të begatë. Gjithashtu, një zakon tjetër që ruhet në këtë ditë, është zierja e vezëve natën e datës 13, dhe larja e syve me ujin e vezëve të ziera në mëngjesin e ditës së verës. Veç kësaj, ditën e verës, lidhet në dorë një “verore” që është si byzylyk i formuar prej një fijeje të kuqe dhe një fijeje të bardhë. Verorja hiqet kur sheh dallëndyshen e parë, dhe hidhet në ferra që dallëndyshja ta marrë për të bërë fole. Të gjitha këto janë rite që kryhen për të kremtuar ardhjen e pranverës, çeljen e luleve, rikthimin e dallëndysheve e gjallërimit e jetës.

Vizitat

Mëngjesi i 14 marsit nis me vizitat tek të afërmit, ku djali më i vogël i familjes nxiton të dërgojë hisen e ndarë. Pikniku nis në orën 10:00. Por vitet e fundit aktivitetet për rastin e festës nisin një orë më parë. Kopshtaret e luleve dhe këngët e traditës

Dita e Verës nuk ka kuptim pa lulet dhe këngët. Prej kohësh elbasanasit njihen si kopshtarë me nam dhe këngëtarë të shpirtit. Lulet më karakteristike në Elbasan janë jasemini, karafili, trëndafili, zymbyli, karakaftet etj. Kultivuesit kujdesen për lulet në mënyrë që ato të shpërthejnë Ditën e Verës.

Gjatë natës dhe Ditën e Verës këndohen me pasion të veçantë këngët e mjeshtrit të muzikës popullore qytetare Isuf Myzyrit. Këngë të tilla si: “Një lulishte me trëndafila”, “Ç’u dëshiruesh me të pa”, “Ma mirë n’ pyll se sa n’ qytet”, “Si bilbili në pranverë” etj., këndohen jo vetëm nga elbasanasit, por në mbarë trojet shqiptare.

Nata e Verës

Përveç Ditës së Verës, dibranët festojnë dhe Natën e Verës, ku gjithë qyteti duket sikur e ka pushtuar djalli me zjarret e ndezur. Ku



fëmijët e vegjël bëjnë parapërgatitje 1 vit përpara, duke mbledhur goma qe pikërisht të ndizen Natën e Verës!

Pas kësaj vjen dhe më e bukura, ku njerëz nga më të ndryshmit bëhen të gjithë rebelë për një natë, duke u mbyllur dyert e shtëpive në qytet dhe fshatrave. Të nesërmen është dita kur thyhen me mijëra vezë derisa të dalë veza fituese më e forta nga të gjitha! Është dita kur nëna bën: (siç thonë dibranët) “ferci, ferci nona, u bëfsh ma i fort se thona”. Është dita kur njerëzit dalin dhe festojnë fushave të bukura me lule dhe gjelbërim, jo asfalteve të mbushur me pluhur.

Verore

Dita e Verës ishte dita e verojkave (ose veroreve). Nëse i referohemi “Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe” (viti 1980, faqe 2135), verojka ishte një gjalmë i përgatitur me fije të kuqe e të bardha që ua lidhnin fëmijëve në duar apo në qafë në Ditën e Verës (verojka, verore, nga verë). Por, siç shkruan Konica, me verore rrethoheshin edhe degët e thanave, dëllinjave, dafinave apo shelgjeve. Në shumë raste në Ditën e Verës thureshin kurora dhe i varnin në portat e shtëpisë, për të sjellë fat.



Arkitektura tradicionale është një koncept dinamik që ka ndryshuar gjatë viteve. Është mënyra për të ndërtuar, duke përdorur simbole të njohura të një kulture të veçantë të njerëzve unikë në një mënyrë specifike. Kështu, shumë njerëz kanë rënë në dashuri me ndërtesat tradicionale për shkak të karakterit, vendndodhjes dhe historisë së tyre të veçantë. Është ajo, e cila identifikon kulturën e vendeve të ndryshme, është ajo, e cila flet nëpërmjet imazheve të papërsëritshme të ndërtesave shumëshekullore.

...E pra, janë ndërtuar në mënyrë artizanale nga dora e qindra arkitektëve ndër shekuj, në kushte tepër të vështira dhe arrijnë të na mahnitin edhe sot, sa që pyesim veten: si është e mundur?!... Disa nga strukturat më të vjetra të krijuara nga njeriu në botë u ndërtuan me përdorimin e mjeteve bazë dhe materialeve lehtësisht të disponueshme.

Nëse marrim shembujt e qytetërimeve më të vjetra në botë, të cilat kanë ruajtur deri në ditët e sotme objekte arkitekturore nga më madhështorët, kuptojmë vlerën e vërtetë që ato mbartin, duke rezistuar për shekuj e shekuj. Disa nga objektet më të njohura e më të vizituara në botë, të cilat janë ende funksionale edhe sot, janë pikërisht ato të ndërtuara në shekujt e parë pas Krishtit. Janë të pabesueshme veprat mahnitëse si për shembull katedralet, të cilat i gjejmë në vende të ndryshme të Europës, si p.sh. në Stamboll, ku ndodhet “Hagia Sophia”...



“Hagia Sophia”, e cila shkakton ende polemika. Me një sipërfaqe prej 7,960m², kjo është strukturë e rëndësishme bizantine dhe një nga monumentet më të mëdhenj në botë. Ajo u ndërtua si një kishë e krishterë në shekullin e 6-të (532–537) nën drejtimin e perandorit bizantin Justinian I. Në shekujt e mëvonshëm ajo u bë xhami, muze dhe përsëri xhami. Ndërtesa pasqyron ndryshimet fetare që kanë ndodhur në rajon gjatë shekujve, me minaret dhe mbishkrimet e Islamit, si dhe mozaikët luksoz të krishterimit.



Panteoni, i cili mbijetoi përfundimisht nga djegia. Panteoni, i cili është një nga monumentet historike më të njohura të Romës, është ndërtesa më e vjetër në botë që është ende në përdorim sot, e ndërtuar rreth vitit 125 pas Krishtit nga perandori romak Publius Aelius Hadrianus. Që nga shekulli i VII, ajo ka qenë një kishë katolike romake.

Panteon do të thotë “të gjithë perënditë”, megjithëse zakonisht mendohet se struktura ishte një vend adhurimi kushtuar hyjnive romake, qëllimi i tij origjinal është në të vërtetë i panjohur.



Jetë të mbetura në gur, Katedralja e Përjetshme e Këlnit. Katedralja e Këlnit, në Gjermani, ka filluar ndërtimin në vitin 1248. Ndërtimi i kësaj kryevepre gotike u zhvillua në disa faza dhe nuk përfundoi deri në vitin 1880. Gjatë shtatë shekujve, ndërtuesit

Arkitektura shumëshekullore, mahnitëse edhe sot, në bumin e teknologjisë

e njëpasnjëshëm u frymëzuan nga i njëjti besim dhe një frymë besnikërie absolute ndaj planeve origjinale.

Katedralja e Këlnit është kishë katolike romake, kisha më e madhe gotike në Evropën veriore dhe përmban kulla të mëdha binjake që janë 157 metra të larta. Katedralja u caktua një sit i Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s në 1996.

Katedralja më e vjetër u shkatërrua nga zjarri në vitin 1248 dhe menjëherë pas kësaj filloi puna në katedralen aktuale, e cila ishte projektuar në stilin gotik në imitimin e arkitekturës së kishës franceze. Gjatë viteve 1790, trupat e Revolucionit Francez pushtuan Këlnin dhe e përdorën katedralen si një stallë dhe një hambar bari. Puna e restaurimit filloi në vitet 1820, e nxitur nga Sulpiz Boisserée, një përkrahës gjerman i lëvizjes së Rilindjes Gotike. Në vitin 1842 u hodh një gur themeli i ri nga mbreti Frederick William IV i Prusisë dhe puna për të përfunduar katedralen rifilloi me zell. Arkitektët Ernst Friedrich Zwirner dhe Richard Voigtel e kryen ndërmarrjen, të udhëhequr nga vizatimet arkitekturore të bëra rreth vitit 1300. Ndërtimi përfundimisht u mbyll në 1880.



Duomo është kisha e pestë më e madhe në botë. Thuhet se ka më shumë statuja në këtë katedrale të stilit gotik se në çdo ndërtesë tjetër në botë. Janë 3 400 statuja, 135 gargojla dhe 700 figura që dekorojnë Duomo-n e Milanos.

Duomo-s së Milanos i janë dashur mijëra punëtorë, një sistem i ri kanalesh dhe mbi gjashtë shekuj për t'u përfunduar. Ndërtimi i Duomo-s filloi zyrtarisht në 1386 dhe përfundoi në vitin 1965. Edhe pse fillimisht filloi në gurë terakote, sapo u realizua madhështia e projektit u zgjodh mermeri kondoglian nga Lago Maggiore. E gjithë ndërtesa është e përbërë nga ky mermer i bardhë me ngjyrë rozë. Mijëra artistë, skulptorë dhe punëtorë të specializuar u përfshinë në ndërtimin e Katedrales së Milanos. Arkitektët nga e gjithë Evropa u ftuan të punonin në projekt (të paktën 78 arkitektë të ndryshëm gjithsej) dhe ndërsa ai rritej e rritej, ndërtimi i tij u zvarrit gjatë viteve. Ai u shenjtërua në vitin 1418, por megjithatë ndërtimet e rënda vazhduan edhe për 200 vjet të tjera.



Kulla e Herkulit ndriçon ende rrugën pas mijëra viteve. Romakët e lashtë ishin vërtetë të mirë me pushtimin dhe gjithashtu shumë të mirë në ndërtimin e gjërave pasi merrnin pushtetin. Dhe ata ndërtuan gjëra që të zgjasin një kohë të gjatë. Kjo është arsyeja pse Evropa ka mijëra ndërtesa romake ende në këmbë, por ka vetëm një far, i cili jo vetëm që ekziston ende, por bën ende funksionin e një fari - Kulla e Herkulit në Spanjë. Sipas UNESCO-s, është i vetmi far i

lashtësisë greko-romake që ka ruajtur një masë integriteti strukturor dhe vazhdimësi funksionale. Ndërsa historianët nuk janë të sigurt për datën e saktë të përfundimit të farit, ajo ishte rreth fundit të shekullit të parë pas Krishtit. Fari sigurisht që ka pasur nevojë për pak ndihmë për të qëndruar në formë kaq të mirë për gati 2000 vjet. Në vitet 1700, një restaurim e bëri atë me një strukturë më të fortë dhe pak më të lartë. Por është ende një vepër mbresëlënëse e arkitekturës antike që mbetet e dobishme edhe sot.



Acoma Pueblo ka strehuar amerikanët vendas për shekuj me radhë. Nuk ka dyshim se Acoma Pueblo në New Mexico është jashtëzakonisht e vjetër. Shërbimi i Parqeve Kombëtare thotë se Acoma është një nga komunitetet më të vjetra të pushtuara vazhdimisht. Është vlerësuar se është themeluar që në vitin 1100 pas Krishtit, megjithëse historia gojore lokale thotë se njerëzit kanë jetuar atje “përgjithmonë”. Kjo pasqyrohet në emrin e saj - në dialektin vendas, “Acom” do të thotë “një vend që ka qenë gjithmonë”.




Tempulli Nanchan dëshmon se druri mund të zgjasë përgjithmonë nëse tregohet kujdes. Gurët që zgjasin qindra vjet janë një gjë, por druri është diçka tjetër. Çuditërisht, Kina është shtëpia e Tempullit Nanchan, një kompleks, salla kryesore e të cilit është ndërtesa më e vjetër prej druri në vend. Sipas “China Culture”, një mbishkrim në një tra në tempull thotë se është ndërtuar në vitin 782 pas Krishtit. Kjo e vendos atë në mes të dinastisë Tang.



Castel Sant'Angelo ka kaluar disa ndryshime. Castel Sant'Angelo ka kaluar 1900 vitet e fundit, duke u përpjekur të gjejë veten. Sigurisht, fizikisht është në Romë, por çfarë lloj ndërtese është menduar të jetë? Këto ditë, është vendosur të jetë një muze, por kjo filloi vetëm shekullin e kaluar. Mund të ndryshojë nesër, sepse Castel Sant'Angelo i ka provuar të gjitha.

QENDRA E PERSONEL REKRUTIMIT, PORCAT E ARMATOSURA DO TË REKRUTOJNË KANDIDATË PËR:



> **USHTARË/DETARË AKTIVË NË FA**(minimalisht me arsim 9 vjeçar):

Prill, Shtator, Dhjetor 2024

> **STUDIME USHTARAKE NË BRITANINË E MADHE** (me bachelor, ushtarak):

afati deri 18 Mars 2024

> **STUDIME USHTARAKE NË ITALI**, në Modena & Livorno (me arsim të mesëm):

Dhjetor 2024

> **STUDIME USHTARAKE NË TURQI** (me arsim të mesëm):

Korrik 2024

> **STUDIME USHTARAKE NË GREQI** (me arsim të mesëm):

Korrik 2024

> **OFICER/STUDIME NË AFA** (me bachelor):

Gusht 2024

> **STUDIME USHTARAKE NË SHBA** (me arsim të mesëm):

Shtator 2024



Apliko Tani



www.mod.gov.al

